

INTERVISTË ME HATMONE HARADINAJ DEMIRIN

Prishtinë | Data: 11 mars, 2022

Kohëzgjatja: 94 minuta

Të pranishëm:

1. Hatmone Haradinaj Demiri (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Hatmane, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu datën e lindjes, vendin.

Hatmone Haradinaj Demiri: Unë jam Hatmone Haradinaj Demiri, e lindun në fshatin Gllogjan, komuna e Deçanit, viti i lindjes 1960.

Anita Susuri: A mundeni me na tregu diçka për familjen e juaj të parë, prejardhjen e juaj?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po sigurisht, se, unë rrjedhë vërtetë prej një familje të njohur, sidomos kombëtarisht. Të parët tonë, po shkoj te gjeneza shumë ma herët që jemi sot, domethonë i pari jonë, i familjes Xhemajl Haradini ka mbetë i vrarë në kullën e Abdullah Pashë Maxharrit në Gjakovë, pra në mbrojtje të Gjakovës. Ai osht', sot osht' heroj, domethonë ka ra atëherë në kullën e Abdullah Pashë Maxharrit. Pas... katragjyshi, domethonë, p'i bjen stërgjyshi jonë, ma vonë bie në Luftën e Dytë Botërore. Kemi të vramë edhe Ramush Haradinaj, i cili ka qenë në luftë, në Luftën e Dytë Botërore dhe i cili sot gjendet, eshtrat e tij gjenden në Beograd. Sot e kësaj dite kanë mbetë atje.

Domethonë, kur kthehet nga lufta, ftofet nga ajo luftë edhe në atë kohë domethonë kanë qenë rrethanat jo shumë të lehta për shëndetësinë, e sidomos në rrethana të Kosovës, e kanë dërgu në spital, në ni spital, spital, pneumoni, më duket ashtu, tash nuk e di si thirret dhe atje vdes. Rrethanat kanë qenë jo shumë të lehta dhe kur kanë shku aty e kanë vorrosë, edhe sot e kësaj dite eshtrat e tij gjenden në, në Beograd. Pastaj lufta tjetër tash e fundit që, domethonë fshati Gllogjan njihet si ni, si ni fortifikatë ose ni qëndresë e luftës së fundit, që tash mo veç i dini, përmenden domethonë të gjithë kushëritë e mij, të gjithë kanë qenë en luftë.

Por, që, domethonë kthehem tash prapë te vitet e '80-a, kur unë si nxënëse e shkollës së mesme, po edhe para se me shku në shkollën e mesme jemi brymosë me ide patriotike, me ndjenja kombëtare prej familjes, duke e ditur edhe rrethanat çfare kanë kalu prijësit tanë, pinjollët e familjes tonë dhe gjithmonë domethonë e kem pasë një urrejtje, jo urrejtje ndaj njerëzve, por ni urrejtje ndaj ni sistemi i cili gjithmonë shqiptarët i ka, i ka diskriminu.

Anita Susuri: Po du m'u kthy pak mrapa, te...

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, kthehem prapa, që nga shkolla fillore, domethonë unë kam kry shkollën fillore në Irzniq, një fshat Irzniq. Në ato rrethana, shkolla fillore, ndoshta kom qenë pak ma e re, më ka interesu shkollimi shumë. Mirëpo, kur e kom kry klasën e tetë, atëherë ka qenë klasa e tetë, kanë qenë rrethana jo shumë të lehta për ni vajzë me shku edhe me u shkollu. Pikërisht, domethonë, unë e kreu klasën e tetë, edhe pse kisha ni përkrahje nga prindi im, për t'u shkolluar, ish ni sfidë e rrethit. Prandaj, ishin edhe sfida e rrethit, mentaliteti, ishte koha jo shumë e lehtë dhe unë qëndrova ni vit në shtëpi.

Mirëpo, kembëngulja ime ishte e madhe edhe ndaj prindit edhe ndaj rrethit, i sfidova edhe isha aq kembëngulëse, saqë ju thashë prindërve, "Nese ju nuk më lejoni me shku në shkollë ose do ta kaloj kufirin dhe do të dal në Shqipëri ose do të iki prej familjes." Kështu që, mas ni viti unë fillova, fillova gjimnazin, atëherë domethonë ishte ni liri, jo vetëm për mu, por ishte edhe për vajzat tjera, sepse të gjitha vajzat pasi unë e theva akullin në fshatin tim, atëherë të gjitha vajzat tjera kishin rrugën e hapur.

Domethonë, u dashtë me mësu shumë, u dashtë mu sjellë shumë mirë me rrethin, shumë mirë me njerëz, që ndoshta më ka ndodhë shumë herë që 200 herë e kom përshëndet një njeri edhe s'ma ka kthy përgjegjen. Dhe në fund më thotë, "Pse po më pershëndet kur nuk po du me të pershëndetë?" I thashë, "Ti kurrë mos më pershëndet, unë çdo herë kom me të thonë mirëdita". Dhe në fund, pikërisht një fshatar i imi thotë, "Më munde, tash e tutje boma mirëdita". Domethonë, ka qenë këmbëngulja ime që m'i tregu që vajzat që shkojnë në shkollë, nuk janë ato vajzat të cilat jonë të përdala ose ashtu siç i ka mendu mentaliteti, por janë vajzat të cilat shkojnë me u shkollu, të cilat dojnë me kontribu për rrethin, për shoqërinë, e sidomos për femrën shqiptare.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë, prindtë e ju, familja çfare ka qenë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Eh, baba im ka qenë, ka pasë ni Shkollë Normale, pastaj ka qenë ni Komerciale. Dhe sfida e babait tim ka qenë, sepse, domethonë ai kishte dëshirë shumë të shkollohej, ishte rritë në ni familje të madhe, familje 40-50 anëtarëshe, i cili edhe ai e dëshironte shkollimin, por që i kishte sfidat e veta edhe ai si mashkull. Prandaj, thotë, "Ika nga bjeshka dhe shkova në Shkollën Normale në Pejë" atëherë Komerciale "dhe kur shkova" thotë "nuk më pranunë en shkollë se thanë, 'ti je familje e pasun nuk të shkollojmë pa pare'".

Shkollimi paska qenë pa pare në atë kohë dhe fati i tij ndodhë që, Ernest Koliqi kur i dërgon mësuesit në Kosovë, e pyetë baben tim, ndërsa i thotë, “Pse po të kthejnë?” Thotë “Unë po kom dëshirë”, thotë “jom ikë”, thotë “prej lopëve, i kom lonë të gjitha në bjeshkë, jom kthy” thotë, “po du m’u shkollu”, dhe domethonë ai fati i tinaj, ai e merr edhe e fut në Shkollën Komerciale atje. E kryen dy vjet, pastaj shkon ushtar. Edhe kur shkon ushtar atje, pak, disa njerëz aty të rrethit që e kanë pa që ky po shkollohet edhe ka tjera pikëpamje, shkojnë edhe e lajmërojnë e i thojnë këta, “Duhet me çu ushtar, me hekë prej shkollës se priset”. Osht’ tjetra, kur shkon atje, domethonë fati i tij qëllon se kur shkon ushtar, i caktohen tri vjet dhe atje qëllon në Kroaci, në Vis edhe në Var qysh tregon, edhe atje prapë shkollohet.

Domethonë, gjatë ushtrisë shkollohet edhe e merr ni, e merr ni shkollim adekuat, pa marë parasysh se e kishte edhe përkrahaz ushtrinë. Dhe kur kthehet, domethonë ajo sfida kur u kthy këtu, ishte ni sfidë krejt tjetër që unë të shkollohna edhe gjithmonë domethonë ja kom zonë atëherë krytë, i kom thonë, “Pse ti je shkollu edhe i ke pa...” kur më ka tregu se... thotë, “Femrat në Kroaci ishin të vjetra dhe shkonin me bicikull me lexu gazetën”, thashë “Edhe unë po du me shku me bicikull me lexu gazetën”, thashë, “se jom shumë ma e re se ato plakat e Kroacisë” (buzëqeshë). Kështu që, kjo ka qenë ajo. Nana ka qenë ni vajzë, me ni shkollë fillore katër vjeçare, po shumë e mjaftushme për to, se na për shembull me marë e me mësu shkronjat edhe me na ofru, punëtore kjo ka qenë.

Anita Susuri: Thatë që e keni pasë të vështirë me thy atë barrierën për me vazhdu shkollimin, pastaj qysh ka ndodhë, a keni udhëtu apo?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, kemi udhëtu tani. Koha ka qenë, rrethanat jo shumë të lehta. 15 kilometra kemi udhëtu me shku në gjimnaz edhe 15 jemi kthy, edhe i kemi bo 30 kilometra në ditë. Në shumicën e rasteve ndoshta ka ekzistuar ni transport atëherë, po ni transport i rrallë, që ndoshta kur u prishë me mujë s’u ndreqë. Kështu që, na i kemi kalu ato sfida me 30 kilometra në kamë që kemi shku në gjimnaz. Mirëpo edhe asniherë nuk jemi vonu, u dashtë m’u çu në ora 5:00, m’u pregatitë, me shku me mrrin, edhe në qoftse... se për shembull te shkolla ke shku edhe je vonu, s’të ka lonë me hy mrena hiç.

Domethonë, ka qenë rregulla strikte edhe pse gjimnazi, tash po e thom se gjimnazi “Vëllëzërit Frashëri” në Deçan në kohën kur unë, me të vërtetë ka qenë një ndër vatrat e diturisë, një ndër shkollat më të njohura në Kosovë në atë kohë, domethonë ka qenë një mësim vërtetë cilësor. Profesorët kanë qenë të gjithë të shkollumë, domethonë të gjithë profesorët që kanë qenë, ndoshta për shkak se ka qenë një qendër e vogël edhe të shkolluar ka pasë mjaft, kanë qenë shumë të zgjedhun edhe shumë të ngritun, edhe kemi marrë ni shkollim me të vërtetë adekuat.

Ma vonë domethonë, gjatë gjimnazit fillunë veç ato sfidat, vitet ‘76, ‘77, ‘78, atëherë fillunë ato lëvizje të ndryshme, lëvizjet pak viteve ‘68, shkunë u rifreskunë edhe iherë me këto vitet. Na fillumë të brymosemi si nxanësa në shkollë të mesme, të lexojmë revista ilegale, të lexojmë pamflete, lexojshim Adem Istrefin, lexojshim Shotën dhe Azem Galicën, do vepra që atëherë ishin... ose Dritëro Agolli,

“Nënë Shqipëri”. Mirëpo, përkrahja ishte e madhe edhe prej profesorëve, sidomos profesorit të gjuhës, të cilin e kom pasë edhe kujdestar klase. Dhe ai gjithmonë, domethonë kur kemi shku në bibliotekë, tash pikërisht jom në këtë bibliotekë, gjithmonë si nxanëse jom shku edhe kom kqyrë ni titull të librit ose ni libër që doket i bukur jashtë.

Dhe ai gjithmonë e ka nxjerrë nga sirtari thotë, “Kjo është për ty, kjo është për ty”, domethonë gjithmonë e dinte se nga cilat familje rrjedhnim, edhe librat na jepke sipas përkatësisë familjare, kah, kah m’u orientu. Kështu që, domethonë u bomë ni grup i shokëve e shoqeve atëherë në gjeneratë që fillumë me i shkëmby ato librat, ato libra që ishin ndoshta pak ma ilegale ose për shembull “Lahutën e Malësisë” e cila ishte shumë e kërkume dhe ishte shumë edhe e rrezikshme me t’u gjetë në shtëpi. Por, megjithatë, ne kemi gjetë mënyra dhe forma m’i lexu këto edhe me qenë ndoshta, kemi fillu m’u bo desidentë shumë herët.

Anita Susuri: E qysh, po më intereson, qysh ka fillu, tregutë, po kush ka qenë qaj për shembull, a është ditë kush i ka prur qato libra apo qysh kanë ardhë deri te ju?

Hatmone Haradinaj Demiri: Eh, faktikisht, fillimisht nuk e kemi ditë. Dikush i ka sjellë, ndoshta profesorat, ndoshta dikush. Po, fillimisht domethonë gjatë shkollës së mesme, dej, dej vonë nuk e kemi ditë, ma vonë domethonë po. Ma vonë se kushërinë jem, tash nuk p’e thom, se baba s’e ka pasë bash vëlla, po ne kemi qenë shumë të afërt, Ismail Haradinaj, i cili ka qenë profesor i edukatës fizike, ai ka qenë edhe udhërrëfys i familjes tonë, sepse ai ka qenë edhe mësimdhanës edhe ai gjithmonë i ka ble ato libra edhe ka pasë ni lidhje të drejtëpërdrejtë me Jusuf Gërvallën, me Bardhosh Gërvallën, me Kadri Zekën, me këta. Dhe, domethonë i kanë gjetë mënyrat që neve na i kanë dërgu, iherë fillimisht përmes disave, toni ma vonë kur kanë fillu ni besim atëherë na i kanë dërgu neve, disa libra që janë botu jashtë. Sidomos ato kanë ndodhë në vitin ‘79, ‘80, ‘81, këtu ka qenë ajo, ajo pjesa ku veç na kemi fillu pak m’u pjekë edhe me besu dikush në neve, që na i marrim ato libra edhe i shkëmbejmë me, me shoqërinë tonë.

Anita Susuri: E këto librat ku i kanë mbajtur për shembull, a kanë qenë kështu në sirtarë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Jo, sigurisht ato kanë qenë, jo ato kanë qenë pak ma ilegale. Bile i kemi majtë, i kemi, i kemi gjetë mënyrat me i pështjellë, me i majtë ose me i shti me ni libër të serbishtes ose dikun, gjithmonë, domethonë, nuk jonë konë të lehta edhe e kemi ditë domethonë, në momentin që ja kemi dhonë dikuj, e kemi ditë kujt, që ai nuk e qet atë libër.

Anita Susuri: E për shembull, ju, a ju ka ndodhë juve personalisht me ja përcjellë dikujt, edhe a keni ndje rrezik ose frikë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Sigurisht, po, kemi ndje rrezik, qysh jo. E kemi ditë që për shembull momentin që e kemi marrë atë libër kem thonë, “Ti e ke marrë, po a je i zoti me marrë?” Domethonë,

“A je ai i cili munesh me marrë edhe me rujtë edhe mos me ra në dorë të dikujt tjetër?” Megjithatë, po ndoshta rinia i bon të vetat edhe nuk, nuk frigoresh.

Anita Susuri: E ku i keni lexu këto libra, në shpi apo?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, i kemi lexu edhe në shpi, ndoshta i kemi lexu edhe, besa ka ndodhë ndonihërë edhe gjatë orëve, kur e kemi pa që ni profesor, e kemi ditë çka, kah e ka orientimin, sidomos profesori i historisë, profesori i gjuhës. I kemi lexu bile, a din, i kemi bo pak si, pak si me ni, me të thonë të drejtën tash me ni lloj snobizmi, se m’i tregu profesorit shka jom ka lexoj. E veç na ka vështru kështu me ni sy edhe nuk ka bo zo, e ka pa, domethonë sikur ja kemi prezentu jo drejtëpërdrejtë. Por edhe sot na ndodhë, domethonë gjatë parakalimit nëpër rreshta të nxanësave asishne e qitshim pak me i tregu, që e dishim kah e ka ajo orientimin, edhe nuk...

Po, interesant ka qenë kur në vitin e katërt, profesori na qiti ni temë të hartimit, ajo më kujtohet, kom qenë maturante, edhe na qetë ni frazë të Kadaresë “Karvani i gjatë i maleve priste me vite, kish pritur me shekuj, priste Shqipëria një udhëheqës” (buzëqesh). Edhe ish kjo fraza e Kadaresë, krejt komplet ka qenë titulli i hartimit. Edhe tash, kush e kishim orientimin çka, nuk ish problemi që na dishim kush osht’ Enver Hoxha, sistemi i Enver Hoxhës, qëllimi ishte që Shqipëria osht’ vendi ynë, i ndamë, edhe unë aty domethonë i tregova pikërisht e shkrova titullin. Gjatë hartimit aty ja bona “E”, që po tregoj kush osht’ ai udhëheqësi që po pret Shqipëria, pikërisht aludojshim atëherë për Enver Hoxhën, sepse ishim nxanësa të shkollës të mesme dhe e kishim idol. Domethonë, Enver Hoxha ka bon dishka shumë të madhe për ne {ngrit duart lart}. Megjithatë, ishte orientimi, shumë ma mirë orientimi që jemi shku nga Shqipëria e jo këndeje. Pra, ishin ato, s’mund ti mohojmë.

Anita Susuri: E ju, për shembull si nxanësa atëherë, a ju kujtohet qysh e keni paramendu Shqipërinë, ose sistemin?

Hatmone Haradinaj Demiri: Uff! Unë e kom paramendu Shqipërinë, sepse unë e kom shiku televizionin dhe, domethonë në Dukagjin e ka rrokë krejt televizionin. Dhe televizioni aq ka qenë prefekt, sa që na kemi mendu që atje osht’ gjithshka në rregull, sepse kemi përcjellë kuize, kemi përcjellë emisione, gjitha ato. Unë televizionin e Beogradit, atëherë që ka qenë vetëm dy orë Radio Prishtina, na e kemi shiku veç TVSH-në. Gjithë këta filma që jonë tash, që jonë në arhivë, na veç i kemi pa atëherë kur jonë shfaqë, domethonë Kinostudio “Shqipëria e Re”. Gjithë ata filma i kemi pa edhe i kemi përcjellë edhe ato. Edhe unë kom mendu që me të vërtetë aty është parajsë, kam mendu që kanë edhe bombë atomike në atë kohë, unë si fëmi, po ndoshta edhe shumë tjerë i kemi pa.

Edhe nuk kom mujtë me marrë me mend që ndoshta mas atij televizioni, mas gjitha atyne që i kemi pa, nuk osht’ diçka që na e kishim dëshiru. Po, kom mendu që me të vërtetë aty osht’, oratoria ishte, kemi mësu atë gjuhën e tyne, po gjuha atëherë ka qenë edhe shumë ma e, shumë ma e mirë, gjuha, edhe shqipe, edhe ma e pastër, edhe në atë kohë e... televizioni shqiptar, pra i kemi, i kemi shiku të

gjitha, i kemi pa. I kemi paramendu bukur, kom thonë a osht' andërr ndoniherë me shku me pa Shqipërinë, edhe pse domethonë kur kom shku në vitin 2000, nuk mu ka dokë asgja keq, sepse ajo andrra vetëm me shku me pa. Pa marë parasysh se dikush është zhgënjy, unë s'jom zhgënjy, kom thonë, vetëm pse nuk e kom ëndrru asniherë që muj me prekë tokën shqiptare me komë time.

Anita Susuri: Viti 2000, u konë hera e parë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Viti 2000 ka qenë hera e parë kur kom mrrri.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe qysh ka fillu ky vetëdijësimi kombëtar, prej familjes po thoni, po ju vetë si person për shembull, qysh keni fillu me vërejtë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, po sigurisht na kemi vërejtë, përveç prej familjes, përveç prej literature, prej librave, prej aktiviteteve, prej, domethonë e shihshim se, fillunë njerzhtë, domethonë të burgosen, lexojshim për Adem Demaçin, lexojshim, domethonë atëherë veç fillumë na me hy në ato rrjedha pak. Jo veç sa na kanë tregu familja për ato ngjarje që na kanë ndodhë, por domethonë edhe pleqtë e tonë. Unë kom qenë ni vajzë e cila e kom pasë dëshirë ma shumë me nejtë me burra se me gra. Interesimi jem ka qenë shumë ma i madh, sepse burrat tregonin histori të ndryshme edhe gjithmonë jom shku me ju shërby, jo me ju shërby se kisha qef me ju shërby shumë, po sa me ndëgju.

Kanë qenë ato odat-shkolla, pa marë parasysh se ka pasë edhe ato mentalitete të atyne burrave me mustaqe, po ka pasë edhe gjithçka. Domethonë, u interpretu Kanuni, u interpretu Pajtimi i Gjaveve, jonë interpretu, kanë tregu për luftëra të ndryshme, kanë tregu për ngatërresa të ndryshme, edhe gjithmonë domethonë i kom, i kom, i kom ndëgju kështu me ëndje. Prandaj edhe këto, këto kanë qenë ato nuk e di, njeriu ndoshta pak i mer prej familjes, pak prej shkollës, pak toni prej rrethit, tani edhe rrethanat krijohen në qat' mënyrë. Televizioni që thashë edhe ma herët, televizioni i Tiranës që ka qenë udhërrëfys ndoshta për neve, po të gjitha ato.

Anita Susuri: E përveç këtyne, domethonë zhvillimi, po mendoj për kulturën po du me ju pytë, për zhvillimin kulturor. Ju sigurisht keni vizitu ndoshta edhe kinematë që kanë qenë atëherë ose që jonë jepë filmat?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, edhe aty ka ekzist, pikërisht prapë po kthehna tash te shkolla e mesme. Në Deçan ka qenë ni kinema, ka qenë ni kinema që ka funksionu shumë mirë edhe me filma. Po edhe ka qenë, ka qenë, ka qenë jeta kulturore shumë e zhvillume, ni pjesë e madhe të aktorëve, që edhe sot jonë në Teatrin e... Popullor në Prishtinë, kanë qenë aktorë edhe në Deçan. Domethonë, jonë lujtë shfaqje të ndryshme, jonë majtë aktivitete të ndryshme, jonë marë recitime të ndryshme. Domethonë edhe si nxanësa jonë organizu aktivitete në shkollë, sidomos domethonë drama, sidomos "Halili e Hajria" e këto.

Aty veç kemi fillu pra edhe aktivitetet, po ka qenë shumë e organizume, jo, domethonë atëherë, ka qenë shumë ma e organizume se sot jeta kulturore. Ka pasë rapsodë të ndryshëm, po edhe nxanësit kanë mujtë me marrë pjesë. Por, kryesisht, domethonë kemi shku rregullisht në, në sallën e filmave që ka ekzistuar atëherë, tash nuk ekziston. Domethonë, atëherë edhe në ato rrethana kanë ekzistuar, kemi pa ato filmat partizano-gjerman që i shfaqshin ose kanë qenë shumë interesant, ajo “Bidaai”¹ (qesh), filmat indianë atëherë kanë qenë shumë atraktivë, shkojshim, i kemi pa ata filma pak, pak partizano-gjerman, këto kanë qenë ato temat që...

Anita Susuri: Kjo ka qenë si një lloj dalje me shoqe.

Hatmone Haradinaj Demiri: Po dalje me shoqe, me, po e kemi gjetë menyrën edhe aty me shku.

Anita Susuri: E po më intereson, pasi keni përfunduar gjimnazin. Për juve ka qenë sfidë me vazhdu gjimnazin, po për fakultet qysh ka qenë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Eh, atëherë për fakultet veç e kom pasë rrugën e hapun, fakulteti veç, nuk e kom pasë problemin as ma të voglin. Jom regjistru në Fakultetin Filologjik, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, aty e kom kry, aty edhe kom magjistru. Eh, atëherë kanë qenë domethonë viti ‘81, unë isha studente e vitit të parë, domethonë kanë shku pesë, gjashtë mujë, shtatë, tetë mujë derisa ka ardhë 11 marsi. Sot është pikërisht 11 marsi, viti i 41-të [përvjetori i 41] që kam qenë studente e vitit të parë. Dhe osht’ interesant që kom dalë me ble ni mantill të kuqe, e kom ditë që ka me ndodhë domethonë demonstratat, përafërsisht.

Kemi qenë të lidhur me ni shoqen timen Shukrie Kocin, që sot osht’ profesoreshë atje në Glllogovc. Ajo e ka pasë djalin e axhës pikërisht një ndër organizatorët, [Hydajet Hysenin](#), Ali Lajçin, që kemi qenë ni grup i shoqeve, kështu kemi qëndru bashkë. S’di qysh na ka lidhë as vetë, qysh jemi lidhë, po krejt kemi qëllu në qata. Jo ndoshta me ni, me ni organizim të drejtëpërdrejtë, po spontanisht jemi lidhë me ta. Edhe momentin kur jemi dalë krejt, domethonë kemi qenë qajo shoqni, kemi fillu domethonë 11 marsin, demonstrat e para. Ni pjesë e femrave domethonë kanë qenë ni Shemsije Elshani, e tash mos me i përmen, Barije Kastrati e shoqet e asaj gjenerate, që domethonë ajo ditë, ka qenë dita e parë që na kemi dalë drejtëpërdrejtë në protestë.

Anita Susuri: Po, paraprakisht ju jeni anëtarësu në ilegale? A keni qenë anëtare?

Hatmone Haradinaj Demiri: Nuk kom qenë drejtëpërdrejtë në ilegale, drejtëpërdrejtë kështu me ni grup, i kom taku ndoshta shumë grupeve. Po pak noshta edhe familja pak më kanë rrujtë, sepse veç gati sa nuk ndodhën ato shpërthimet, po ato kanë ndodhë domethonë pas, domethonë në vitin ‘81, atëherë kur kushërinj jemi Ismajli ka ra në burg bashkë me grupin e Deçanit e pikërisht edhe me

¹ *Bidaai* (përkth.: Lamtumirë) është një film dramatik indian i vitit 1974, i prodhuar nga Prasad Productions Pvt Ltd.

profesorin tim të gjuhës edhe me profesorin tim të matematikës, ata të cilët mu më kishin dhonë mësim.

Ai ra në burg, u dënu, por unë kom qenë ajo të cilën krejt materialin e tyne e kom pasë të mshefun. Domethonë, si studente e vitit të parë, atëherë e kemi marrë krejt materialin që e kanë pasë të asej organizatës të parë ilegale të Deçanit, e kom marrë e kom mshefë në bahçe, e kom mbyllë, t'u mendu që ajo duhet m'u rujtë. Domethonë, kanë qenë disa materiale aty, kanë qenë do makina, kanë qenë do revista, do, këto i kemi marrë me grunë e axhës. Ato i kemi marë i kemi mshefë, se na duhet m'u rujtë ato. Kështu që, mjerisht ato edhe i gjetën, ato materiale i gjetën, erdh UDB-a² i murën, i tërhoqën ato.

Anita Susuri: Kur i kanë gjetë?

Hatmone Haradinaj Demiri: I kanë gjetë në vitin 1981, në... {mendon}. Dikund kah, kah qershori, maji qashtu, më duket.

Anita Susuri: A ju kujtohet qajo, qysh ka qenë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Unë kom qenë në Prishtinë, domethonë kom qenë si studente, vetëm se më ka ardhë ni kushëri dhe më ka tregu. Thotë, “40 policë i ki në bashçe, dishka kanë gjetë, çka nuk e di”. As familja s'e ka ditë kurkush, domethonë as baba, as nona, as kurkush. Vetëm unë, ajo grua e axhës e kemi ditë këtë proces.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ishim t'u folë për...?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, ishim tu folë për... domethonë isha në Prishtinë, vijnë më lajmërojnë që kanë qenë dikun përafër 40 policë në shtëpinë tuaj. Tash isha, sfida, çka me bo? As s'isha me ardhë në shpi, me ra në sy të pushtetit, as s'isha me nejtë. Megjithatë, grua axhës më lajmëroi. Thotë, “Eja”, thotë “unë kom shku në polici, më kanë marrë në pyetje”, thotë “po, e kom marrë përsipër vetë, i kom thonë, ‘Unë i kom shti ato, kjo le të vazhdon atje’”. Kështu që, fati deshti që, axhën domethonë e torturunë edhe e prunë m'i nxjerrë vetë materialet e veta. Prej torturave të mëdhaja, unë s'e kam pa, motra ka qëllu aty. Thotë, “Vetëm eshnat i kishte pasë në trup”, edhe kalon ajo, kjo sfidë.

Anita Susuri: E grunë e axhës, a e shtinën në burg a?

² *Uprava državne bezbednosti*. Administrata e Sigurimit të Shtetit, i njohur gjithashtu si Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, ishte organizata e policisë sekrete të Jugosllavisë gjatë viteve 1946-1991

Hatmone Haradinaj Demiri: Grunë e axhës e kanë marrë, po tani ma vonë, domethonë ata e kanë marrë në pyetje. Ma vonë, domethonë ja kanë marrë djalin, dy djemtë, dy vajzat, këto që i patëm në fotografi aty që i kem bashkë. Domethonë, i burgosën krejt ren, djali njoni pesë vjet, tjetri tri vjet, tjetri, i madhi u dashtë me ikë, me shku në, jashtë në Gjermani, ka qenë në grup me Jusuf Gërvallën me këta, si student i vitit të parë. Rrethanat, domethonë u dashtë m'u largu edhe deri domethonë u kthy mas 20 viteve në Kosovë, masi jonë kry krejt rrethanat. Asniherë s'u kthy, tek domethonë gjatë luftës u kthy në luftë këtu. Edhe aty kanë mbetë vetëm nana edhe gruja axhës në shpi, me dy vajzat në shpi, gjithë tjetër, domethonë mashkujt, ni në Suedi, dy djemtë edhe baba në burgje, vajzat qashtu, qashtu unë, kushëritë, ren domethonë fshatit.

Unë kam marrë edhe vajza të tjera, në fshatin tonë ka qenë qoftëse edhe vetëm një darsëm ke shku dikun, edhe ka qenë vajzë e fshatit Glllogjan vetëm nëse dorën e ka çu ose e ka bo ni gjest {ngritë lart grushtin} për Shqipëri, i kanë marrë. Ka marrë edhe vajza, domethonë kanë qenë edhe dy tre vajza tjera të fshatit tonë që s'kanë qenë hiç në shkollë, vetëm pse kanë marrë pjesë me ni dasëm e kanë folë diçka, i kanë marrë, i kanë marrë edhe i kanë burgosë. Domethonë, shkaku ishte, se ishin këto grupet, domethonë kushëritë tonë, ishin në atë grupin ilegal, tani ishin edhe tjetër, domethonë tash jonë edhe ni grup tjetër i të rive, e formojnë ni grup të rive, ni grup ma i vjetër.

Kështu që, u bo me të vërtetë fshati jonë, u bo halë në sy për, për armikun. Bile me thonë ni detaj, thotë, "Kishim, mezi e kishin bo ni asfalt", edhe kur e shohin që në '81-shën veç dalin prej fshatit tonë pjesa dërrmuse kundërshtarë, thotë, "Me mujtë", thotë, "me ja u bo këtë asfaltin, jau kishim bo sikur qilimi, jau kishim pështjellë edhe jau kishim hekë", qaq ishin bo nervoz. Por, megjithatë, këto ishin ato rrethanat të cilat me të vërtetë s'kanë qenë të lehta, për kohën kur kemi vepru si studentë, edhe si familjarë, edhe si fshatarë edhe si femna, ka sfida të ndryshme.

Anita Susuri: E qysh ka vazhdu pastaj, aktiviteti i ju?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, ma vonë, domethonë pas vitit '81, 11 marsi... po...

Anita Susuri: Po, paraprakisht, mos te tejkalojmë '81-tën se osht' shumë me rëndësi. Po, po du me thonë, paraprakisht a ka ndodhë edhe te ju kjo shkrimi i parullave ose...

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, po, patjetër. Ka ndodhë shkrimi i parullave, "Kosova Republikë", kemi zbritë prej autobusave, i kemi shkru kaniherë me shkums, kaniherë mas autobusit. Domethonë, të nestrit dalje lajmërimi se shkrunë terroristat "Shkrunë ata!" Na ishim si nxanësa, nuk, domethonë nuk... kaniherë nuk mendojshin domethonë te disa nxansë, po megjithatë domethonë po, kanë shkru "Kosova Republikë". Këto ishin ato, të cilat, ose naj kangë ose dishka. Për shembull e lëshojshim naj kangë si motiv, kangë patriotike, zgjedhshim.

Ni ndër kangët që ka qenë për mu, që e kom dashtë shumë ish ajo “Lis mi lis, në ato shkrepë, ni bylbyl po knon mbi plepa, kom pa njerzë që hanë barotin, kom pa njerzë që ndalin lisen, po s’kom pa si Pal Mylyshin”, ka qenë ajo kanga që nifur motivi, a din që Pal Mylyshi ka qenë ai njeri i cili e ndalë tokën. Kështu që, domethonë këto kanë qenë ato parullat, ato të cilat nëse kemi mujtë më motivu tjetrin, me pa cila osht’ kanga patriotike, cila osht’ kanga, cila e prekë atë tjetrin, kush, çka, parullat...

Anita Susuri: A ka pasë naj organizim ku jonë shkru qeto parullat për shembull, në cilën kohë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, po, sigurisht gjatë natës, kur për shembull, kur jemi kthi me autobus mbramjeve vonë, kur njerzë kanë zbritë edhe kanë hypë, në autobus, na e kemi gjetë kinse po ja nëshojmë dikuj rrugën edhe kemi dalë mas autobusit i kemi shkru, kemi hypë në autobus. Të nestrit, dita, ka dalë ajo e shkru me ajo atje, u bo, u bo nomi.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Në konvikt thatë që keni qenë me disa shoqe që edhe ato kanë qenë të përfshime.

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, shoqet që kem qenë në konvikt atëherë kemi qenë gati shumica të përfshime. Pra, pjesa dërmuese e shoqeve, veç mo u njoftum, e ditëm kush o kjo, kush osht’ ajo, cilat jonë, me cilat kahje po shkojmë. Fillumë tani domethonë me u organizu, me folë, me bisedu, mbramjeve domethonë vonë bisedojshim, çka po mendojmë, “S’po shkon mirë”, shihshim diçka televizione, ngojshim domethonë çka po ndodhë në Jugosllavi atëherë. Kish fillu urrejtja ndaj disa pushtetarëve, sidomos u përmenke atëherë Xhavid Nimani, Rahman Morina, ishin këta që e përfaqësojshin Kosovën, të cilët domethonë i ndëgjojshim. Atëherë fillumë veç m’i ndëgju edhe parlamentin e dishim kush çka po flet.

“Jo, ky osht’ i mirë Remzi Kolgeci, osht’ i mirë”, dikush thojke Mahmut Bakalli, dikush, domethonë fillumë atëherë me i pa përfaqësimin e shqiptarëve në, në sistemin që ishin atëherë jugosllav edhe fillojshim kapak, dikush kush u merke në politikë, shkojshim e këqyrshim “Ti çka po thu, ti çka po mendon?” Domethonë, ato, ishin ato bisedat tona të lira mas mësimi, sidomos kur, në konvikt kur banojshim. Kështu që, fillumë në këto mënyra, pra edhe atëherë veç i gjetëm mënyrën tjetër, unë, domethonë vishin prej Gilanit.

Bile ka qenë interesant se vishin edhe që me na mushë pak me, me nacionalizëm, ishin Tetova e Gostivari, ato vajzat, studentet, se atëherë ishin të gjitha rrethet të Malit të Zi e të Gostivarit, e të Tetovës, e të Preshevës e të gjitha ishin. Edhe zakonisht domethonë ato vishin këtu, thojshin, “Këtu po flasim shqip, atje nuk guxojmë me folë shqip”. Bile njena ni shoqe thotë, “Unë vetëm pse e kom kërku në barnatore” thotë “ni ilaq, i kom thonë, ‘A bon qeta?’ më ka thonë, ‘Pse s’po folë maqedonisht?’ edhe veç pse i kom thonë” tha “unë, ma lehtë e flas gjuhën e nanës” atëherë tha “edhe jom torturu edhe

jom rrehë edhe jom marrë në pyetje”. Domethonë, nuk kanë guxu me lypë asni barë në Maqedoni e në Gostivar.

Atëherë veç edhe ato domethonë pak kanë qenë të Dibrës, kanë qenë nja dy, tri motra që kanë qenë shumë, shumë të brymosuna me ide patriotike atje. Edhe të cilat e kanë pa domethonë shumë ma shumë, se derisa ti nuk ki të drejtë m’u shkollu në fakultet, m’u shkollu në gjuhën tonë, atëherë patjetër se nuk ish edhe e lehtë me ardhë prej Tetove, e prej Gostivarit, e prej Maqedonie, prej Malit të Zi e të gjitha këto. Sidomos vajzat edhe djemtë, por vajzat te na kishim kontaktin shumë ma shumë me vajza, atëherë domethonë aty fillojke urrejtja edhe ma e madhe.

Anita Susuri: E qysh ka qenë para organizimit të protestave të ‘81-tës, demonstratave. Paraprakisht, për shembull, çka u diskutu, a keni ditë për ndonjë organizim a...?

Hatmone Haradinaj Demiri: E, përafërsisht u konë ni lloj, ni lloj organizimi indirekt, jo direkt. Atë natë domethonë, ni pjesë e grupeve këtu, që thashë këto shoqet e mia që i kishin këto, domethonë ajo shoqja e Drenicës që e kishte kushërinin e vetë, ata që ish ni organizator. Po, jo organizator drejtëpërdrejtë me thonë, “Unë p’e marrë”. Po s’e di as vetë qysh osht’ bo ajo, qysh jonë lidhë drejtëpërdrejtë, domethonë ka qenë ai Gani Koci, ka qenë Ali Lajqi që ka banu e dashura atëherë, tash osht’ gruja e tij, po kanë banu bashkë. Edhe tash na ishim shoqe edhe “Sonte ka me ndodhë dishka”. Pra secila e kemi ditë.

E axha jem ma ka bo ni, ni kasetë, më ka thonë, “Merre qeta”. Ma ka rregullu krejt me kangë patriotike, “Merre qeta edhe nsho në konvikt”. Domethonë, qajo ka qenë jo me ta dhonë detyrë drejtëpërdrejtë, unë e kom marrë, edhe domethonë me 10 mars në mbramje gati që askush s’ka flejtë, gjithë natën kemi nejtë jashtë. Koha ka qenë shumë e mirë, e nxehtë edhe tanë kohën e kom nshu kasetofonin në dritare, konvikti numër I, krejt ato kangë patriotike. Toni ma vonë jonë ardhë do kushëri të mi, ma kanë marrë, “Hajde se tash po dojmë me nshu në konviktin numër III të djemve.” Edhe qajo muzikë ka qenë.

Disa jashtë, dikush ka ditë, dikush s’ka ditë. Po ni ndjenjë atë natë që kurkush nuk ka flejtë deri vonë, pra krejt, ka qenë ni lloj, ni lloj lirie para se me ndodhë ajo fortuna që, që ndodhi të nesërmen. Pra krejt kem, e dishim që dishka po ndodhë, jo drejtëpërdrejtë me ardhë me thonë... edhe domethonë atëherë kur veç ka fillu, ka ardhë Gani Koci, e Ali Lajqi e këta me këto vajzat me ni grup. Edhe hajde çka me bo, ka dalë ai, veç ka dalë ai te menza e studentëve, atëherë ju kemi bashkangjitë ni pjesë e madhe na që i dishim tonë.

Jemi bashkangjitë drejtëpërdrejtë te menza i kemi marrë do qepë me veti, i kemi marë edhe do, do gozhda i kemi shti në shishe, as vetë nuk e di pse i merrshim, shka munem me bo. Por, megjithatë ato kanë qenë që i kemi marrë me veti, qeptë nëse na gjujnë [gaz] lotsjellës. Kush e ka bo atë ide na as nuk e dishim, se hera e parë ishim që marrim pjesë në ni demonstratë të drejtëpërdrejtë me gaz lotsjellës. Edhe domethonë ajo natë ka qenë nata që jonë bashkangjitë njerz të në momente të caktume.

Bahria, të kam tregu ajo, e Kastrati ka qenë, për qeta ajo ka qenë pak ma e informume se na. Atëherë unë, ma vonë e kom pasë shoqe, nuk e kom pasë atëherë kur ka fillu ajo me tabak, mos të keqkuptohem. Po, toni ma vonë domethonë jemi lidhë edhe me atë grupin e atyne, jemi lidhë me grupin e Tetovës, domethonë mas 11 marsit atëherë kemi fillu tamon me ditë kush ku jemi, në bazë të daljes në demonstratë. Atëherë ka fillu demonstrata e 26 marsit, ajo ka qenë edhe ma e, edhe ma e organizume.

Edhe pse domethonë edhe në '81-shin na gjujtën, erdhën forca të mëdha policore, po me 26 prill, me 26 mars faktikisht kanë ardhë forca prej Nishit edhe bukur keq kemi pësu. Jonë gjujtë, jonë vra edhe studentë, edhe toni ma vonë ka qenë ajo që po thu, 1, 2, 3 prilli kanë qenë ato demonstratat, jo vetëm të studentëve po ju ka bashkangjitë krejt populli, sidomos Prishtina ishte atëherë fjala. U organizunë edhe kanë fillu tani edhe në qendrat tjera ma vonë domethonë pas atyne. Atëherë kanë fillu edhe represalet tjera, marrja në pyetje, informacione, burgosje, domethonë...

Anita Susuri: A mundeni me na, me na spjegu për shembull ma detajisht çka ju kujtohet prej qasaj periudhës demonstratave? Se pastaj kanë hy forcat edhe nëpër konvikte i kanë nxjerrë studentat.

Hatmone Haradinaj Demiri: Kanë hi forcat në konvikte, po kanë hi, i kanë nxjerrë zhag. Bile, bile rasti konkret osht' i Zekë Sinanit, gazetarit nga Deçani bashkë me të fejumen e tina, që i kanë rrehë drejtëpërdrejtë. Unë nuk kom, kom ikë, domethonë s'kom qenë në atë kohë në konvikt, po ni pjesë kanë qenë në konvikt. Noshta na pak jemi konë ma të shkathtë, se e kemi ditë që s'kthehem atë natë në konvikt, se u ditë çka po ndodhë. Disa kanë ikë të shpija, na kemi shku ku kemi mujtë, nëpër shoqe, ku kemi mujtë me gjetë ndoni vend. Ndoshta hiç të papërcaktumë, po jemi futë dikun, nuk jemi kthy në konvikt.

Kemi nejtë në lagjen e... ktu ku osht', në Breg të Dillit, ni lagje kemi hi, ni shpi të panjoftun, po na kanë lonë mrena, domethonë se... po na thanë "Mos shkoni!" Nuk ishte edhe e lehtë, dikuj edhe ja mbyllshin dyrtë, domethonë ishte friga prej, prej disa njerëzve që ishin demonstrues edhe u frigojshin disa të na i hapshin dyrtë. Eh, shoqni... qashtu njejtë, secili ku kemi mujtë, çka, disa edhe i kanë marrë domethonë gjatë, gjatë protestës, ku kanë mujtë me nxonë e kanë kapë edhe drejtëpërdrejtë e kanë marrë, kush kemi ikë, kemi ikë. Tani ma vonë kanë fillu ato, ato hulumtimet e tyne, kush tek, kush o ky, kush o ai, edhe...

Anita Susuri: E gjatë demonstratave, për shembull ka pasë dhunë, po çfarë dhune ka qenë? A ka pasë brohoritje, çka është kërku?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, ka pasë brohoritje, "Kosova Republikë!" "Trepça prodhon, Beogradi ndërton". "Republikë, ja me hatër..." ato niherë s'kanë qenë, fillimisht kemi thonë se, "Po dojmë kushte", "Duam bukë, duam..." a din, kanë qenë pak ma të lehta, sidomos në fillim të protestës në

menzë. Tani ma vonë gradualisht, si zakonisht kur vijnë domethonë, niherë fillojnë më të vogla atëherë kanë fillu domethonë ato parullat secili me qitë njo, njo të vetën, në mënyrën tjetër edhe deri sa ka ardhë deri te ekstremi. Ka ardhë atëherë në atë kohë domethonë Mahmut Bakallin e kanë kërku, edhe ka ardhë ai kishe pak me, me nalë atë protestën, me thonë, a din, “Kthenu!” Por, megjithatë, domethonë protesta ka qenë, hiç s’ka, s’kanë pranë studentat. Në, me 26 prill ka ardhë më duket Gazmend Zajmi, ka ardhë [Pajazit Nushi](#), edhe dikush ka qenë, tash s’po më kujtohet, i kemi majtë atë, atë protestën në mes të konvikteve tu i thonë me i ndreqë kushtet en menze, me, me pasë kushte për studentë.

Edhe tash ata, ku me gjetë ata, ata s’ishin përfaqësustë e krejt të Jugosllavisë, por ishin pak ma të mirtë që kishin ardhë me bisedu, që pak me na, me na zbutë neve që me thonë, “P’i shikojmë kushtet”, edhe na patjetër domethonë, ata organizatortë tash, veç u, veç u vërejtën, organizatortë dulën pak jashtë në, me të 26-tin, edhe veç apo krijohen kushtet me na tregu drejtë. Edhe momentin që ata s’mujshin me dhonë fjalë që na munem me jau tregu kushtet, ndoshta ka qenë edhe pak strategji e tyre se, Pajazit Nushi e këta kanë qenë domethonë njerëz, nuk osht’ si, afër popullit, jo, në atë kohë të shitun, qysh me thonë, të shitun se, shqiptartë...

Tash unë kurrë nuk du me thonë që osht’ i shitun, se dikush u frigu e dikush nashta e ka pasë e krejt ato, se jemi mësu na gjithmonë me etiketu, po nuk kom dëshirë me etiketu njerëz se, nashta në shpirt e ka pasë dëshirën po u frigu ose familjen ose sidoqoftë. Rrethanat kanë qenë çfare kanë qenë. Kështu që, domethonë, atëherë veç e kemi marrë atë turrin, nuk e di as vetë ka kanë dalë ata flamuj, s’kemi pasë kurgjo, secili flamurin, asishne edhe kemi mësy teposhtë, domethonë te konvikti. Në mes të konviktit I-shit edhe III-shit, atëherë kanë qenë, kemi defilu poshtë derisa kanë ardhë forcat nga Nishi edhe...

Anita Susuri: Çka kanë bo ata, kanë gjujt?

Hatmone Haradinaj Demiri: Kanë gjujtë, po. Kanë gjujtë me, niherë, ma s’pari me topa uji. Ma vonë tani kanë fillu me gjujtë edhe me gaz lotsjellës, po jo veç me gaz lotsjellës po kanë gjujtë edhe armë. Se pikërisht domethonë përmi menzen e studentëve ku ngjitesh përpjetë, si të vjen ka shkolla “Ismail Qemajlit” ajo pjesa, ato shpijat kanë qenë, sepse kanë qenë edhe do serbë, i kanë pasë shpijat aty. Dhe ata kanë gjujtë, domethonë prej shpijave ata serbë që kanë pasë shpijat e veta, kanë gjujtë aty, domethonë kanë gjujtë edhe armë edhe jonë plagosë.

Anita Susuri: Ishit tu na tregu për serbtë, që i kanë pasë shpijat, që i kanë gjujtë.

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, domethonë edhe ata e kanë ndihmu, pikërisht domethonë na nuk dinim a të ruheshim nga, nga forcat, apo të ruhemi edhe nga, nga serbtë që ekzistonin aty. Prandaj, domethonë këto dy kanë qenë rreziket. Fati që kemi shpëtu, domethonë kemi hi te menza e studentëve, në atë pjesën ku osht’ tashti, ka qenë ajo ambullanta edhe ka qenë nifare korridori aty

kemi hi mrena edhe aty domethonë kemi nejtë. Mas ni kohe kanë fillu forcat me ardhë prapë, jemi ikë, u dashtë me ikë, me shku rrugës, Aktashi I, II, III, ku kemi mujtë përpjetë.

Anita Susuri: E përfundimisht çka ka ndodhë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Përfundimisht domethonë atëherë veç u mbyllën konviktet, u mbyllën. Krejt studentat i lëshunë, “S’ka kurkush me shku. Shkoni merrni, shkoni ka të doni. Hecni! S’ka mo!” Domethonë, prej 26 prillit e te mas, domethonë atë vit konviktet mo i kanë mbyllë krejt. Ku studentat, dikush ka shku ku kanë mujtë nëpër vendlindje, disa, pas ni kohë domethonë pas demonstratave 1, 2 prillit, u dashtë m’u kthy ma vonë ku kemi mujtë me gjetë naj shpi private, ku kemi mujtë me kry naj provim.

Edhe ma vonë domethonë ka ndryshu çdo gja, s’ka qenë shumë, domethonë nuk e kem pasë mo atë lirinë en konvikte, se deri atëherë ata nuk e kanë mendu që të gjithë studentat ja kthejnë shpinën edhe të gjithë studentat bohen protestusë e... pjesa e madhe dërmuse. Atëherë, domethonë ka qenë shumë edhe ma e vështirë vendosja në konvikte, kanë, domethonë vetëm ni diçka nese ke pasë ti s’je vendosë, s’të kanë leju. Pastaj kanë qenë edhe në fakultete, kanë fillu domethonë ata që kanë qenë në burgje, të dënumë, s’të kanë pranu as në fakultete.

Edhe në vitin ‘82, pikërisht me 11 mars, ‘82-shi, ni mbrajme vijën na marrin, mu më marrin në shpi, shoqet e mia do në konvikt, do nëpër shpija. Me na izolu se na po e organizojmë prapë në përvjetorin e parë të demonstratave. Edhe erdhën e na murën në izolim, jo me na dënu, po në izolim, “Këto jonë të rrezikshme për rrethin, për shoqinë”. Edhe tani, domethonë jemi burgosë, unë, bashkë kjo shoqja ime Mehmetaj, Tima e Isnqit, qajo Lali Ferra që jemi konë, që jemi taku aty për aty, e plot tjera. Mo kur jemi shku veç e kemi gjetë Ferizajin, nga të gjitha rretheve, të gjitha studentet që kemi qenë, studentet ma të mirat, studente të rregullta, që noshta e kanë, e kanë ditë ata. Përafërsisht, tash mo veç e kanë ditë kush jemi e tek jemi.

Bile, ni polic aty vendas më identifikon atje. Thotë, “E kom identifiku, ka qenë”, thotë, “rregullisht”. Edhe u shku ka lajmëru atje në rreth, nëpër domethonë në vendlindjet tona ku u kthejshim atje. Thojshin, “Kjo ka qenë, e ky s’ka qenë e... e ky ka qenë”. E policisë shqiptare që kanë, na kanë identifiku edhe domethonë e kanë ditë. Mu jonë ardhë më kanë marrë te shpija.

Anita Susuri: E paraprakisht po më intereson a ka pasë naj aktivitet që keni zhvillu pas demonstratave deri në burgosje?

Hatmone Haradinaj Demiri: E kemi zhvillu tani na aktivitete prapë, domethonë jo aktivitete kështu krejt tash me dalë se u kryjnë ato. Tash ish ai problemi, ishin represatet, ishin burgosjet, ishin ato... Ish ni kohë që tash domethonë me mujtë m’u, m’u riformatu prapë ish ajo problemi tashti meniherë me... sepse fillunë domethonë, fillunë burgosjet, fillunë grupet m’u dënu, grupe të ndryshme, nuk dul veç

grupi i Deçanit, dulën grupet e të gjitha vendeve. Atëherë, domethonë ishte pak ni kohë, që u dashtë me pushu pak për me mujtë me u riorganizu. Edhe atëherë domethonë, jo se jemi nalë na, jo që kemi bo ndoshta diçka drejtëpërdrejtë, por biseda kemi pasë, biseda me të njehta qeto çka po ndodhë tash. I kishim ato reflektimet tona, çka ndodhi me këta, çka ndodhi me këta, çka u bo me këta.

Ishin hala ma, bisedat ishin tani ma konkrete, e dishim çka po ndodhë. Atëherë përpara nuk e kemi mendu, po bojmë edhe, hajt se unë e boj, po noshta unë s'bi në atë, në atë pozitë. Atëherë veç kur ra ni pjesë edhe tani fillimë edhe na me i pasë shoqet e shoktë e... dulen para neve u burgosën e... Atëherë veç ishin tjera, tjera rrethana, jo shumë të lehta, jo shumë të lehta me u organizu edhe me dalë drejtëpërdrejtë, sepse tash veç e kish shtri, e kish shtri Sigurimin e shtetit Jugosllavia, e kish shtri shumë keq, edhe nuk ish qaq e lehtë me dalë tash ti drejtëpërdrejtë. Edhe pse domethonë na u dashke me u rujtë tani me u paraqitë pak si të urta, si të buta, mos me...

Anita Susuri: U vendosë po më doket atëherë edhe orë policore, janë ndalu tubimet...

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, osht' vendosë, po, osht', jonë ndalu aty për ni kohë të gjatë jonë ndalu s'ki guxu hiç. Nëse ke metë në Prishtinë, mo ora policore u kry edhe ti s'ke mujtë, kush ka dalë domethonë prej... dikun ka qenë data 26 marsi, 27, 28, kush ka shku te shpija ka shku, kush s'ka shku jemi metë nëpër Prishtinë. S'kem mujtë me shku, se ora policore. Dhe ata tash kanë mendu që s'kem na ku me shku, po fatbardhësisht domethonë pjesa dërmuse e Prishtinës veç i kanë majtë studentat mrena, kush, kush ku ka mujtë.

Anita Susuri: E thatë që qat' ditë që ju kanë marrë në burg kanë ardhë te shpija, a ju kujtohet qajo ditë qysh ka qenë, qysh ka reagu familja ju?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, nuk ka reagu, unë jom çu në mëngjes edhe faktikisht domethonë ka qenë ajo ditë unë shkova në pushim shtune, diele, edhe mendoja të hanën me dalë në Pejë me ble diçka, isha përgatitë për me shku në Pejë, isha përgatitë me shtiklla, se s'mshkojke menja që ka me ardhë dikush te shpija, hiç si hiç, po kom mendu që dishka ndodhë në konvikt nëse na arrestojnë, ose na arrestojnë në akte diçka a din kur dalim në demonstrata. Po sigurisht ata i kishin marë informacionet edhe unë t'u bo gati me shku në Pejë, me dalë me shku në qytet me ble diçka, edhe për familjen edhe për vetën, se vikend.

Vijnë policia te shpija, e thërrasin prindin, kështu kështu, prindi thotë "Kështu kështu, kanë ardhë, 'A din diçka, a çka ke bo?'" I thashë "Kurgjo, sen". Domethonë, s'dojsha me i shqetësu prindtë edhe fati që mrena s'hynë, ata pritën te dera. Mu s'më dhanë kohë as me i hekë as këpucat, kom shku me do taka, që mosvet kanë qenë të nalta që s'jom përgatitë për atë punë, t'u mendu që po shkoj në Pejë. Megjithatë, motrës kom mujtë me i, me i thonë, motrës mas meje, ajo ka qenë në shkollë të mesme, i kom pasë do materiale të Jusuf Gërvallës atëherë, do revista.

Thashë “Kurgjo hiç thashë, veq qato” thashë “munesh” thashë “ti, nëse s’hinë mrena asishne me i marrë, me i djegë, me i hekë”, thashë “ju shpëtoni”. Motra domethonë i ka marë, i ka hekë ato. Unë kom ardhë, domethonë kom shku në Deçan, prej Deçanit më kanë thonë, “Duhet me shku në Pejë”. Prej Peje, “Prishtina të ka kërkun” edhe kom ardhë kom nejtë dikun 24 orë në qendër këtu në Prishtinë. Më murën policia, t’u mendu që hajt, se po, veç ni intervistë ose pyetje, p’e provoj. Kur filloi m’u bo vonë koha, domethonë u bo mbramje, atëherë e dita që...

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ishit tu na tregu për ditën kur ju kanë burgosë, kanë ardhë në shpi, ju kanë marrë, ju kanë prurë këtu në Prishtinë. Në Burgun e Prishtinës ka qenë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Iherë, ma s’pari jo. Sekretariati i Punëve të Brendshme u qujtë, po SUP-i³, qashtu, Sekretariati i Punëve të Brendshme. Kom nejtë dikun nja 24 orë aty, prej masdite domethonë dikun, ka ora katër, deri të nestrit ora dhetë, a nimbëdhetë a, ku e di unë. Domethonë kanë ardhë kohë pas kohë, na kanë marrë në pyetje, “Trego çka ke bo?” Çka asishne, domethonë si gjithmonë, domethonë “S’kem kurgjo”, “Tregoni të vërtetën. Ma mirë osht’ me tregu, je studente mos e hupë karrierrën, fillo me karrierë lej ato sene, ato s’jonë të mira për juve. Ju kanë mashtrur, s’munet m’u prishë shteti”. Këto niherë ishin bindje, a din dojshin me na bindë, “Koke vajzë e mirë, studente e mirë, mos i shkakto familjes probleme”. Domethonë, duke mendu edhe ata që munen me na bindë, u mundojshin pak si me të mirë, me fillu me ato fjaltë e tyre, si zakonisht, si gjithmonë en pyetje.

Mirëpo, domethonë unë si, veç isha e vendosun në atë punë. Kom hy edhe mo domethonë ideali ynë nuk ishte tashti me tregue çka e qysh e. Megjithatë, u vendos, u mundun disa herë. Vishin në pyetje, më lejshin me pushu, “A mendove, a s’mendove? Mendohu edhe pak, mas ni ore na tregon çka”. Prapë mas ni ore, mas dy ore, domethonë ka zgjatë dikun nja, gati 24 orë. Kanë ardhë kohë pas kohe me na marrë në pyetje, gjithmonë t’u mendu që “Po bindesh ti, po të lëshojmë na ty, veç trego”, “S’kom shka me tregu, kurgjo s’kom bo. Nëse unë jom fajtoje edhe po mendoni që kom bo diçka, gabim e keni. Ka njerëz tjerë që ju sillen, e bojnë shumë ma shumë e unë s’kom kurgjo”, domethonë isha...

Në fund domethonë erdhi ni, Ismail më duket ka qenë ni inspektor i fundit kur erdh. Thotë, “Ti ke vendosë me shku në burg” tha “na duhet”, tha “me dhonë vendimin me shku. Po,” tha, “dishka du me të thonë, pyte” tha, “njonin të fshatit të ton, kur të dilsh, ishalla del”, qishtu tha, “pyte ata”, tha “edhe ai të tregon kush jom unë”. A din që kishe, tash me më bind. I thashë “S’kom unë nevojë me njoftë kërkun”, i thashë “unë asni njeri nuk kom nevojë. Kush je ti, kush je, unë s’jemi ardhë m’u njoftu, ju” i thashë, “e keni punën e juve, unë e kom punën time, vazhdoni”, thashë, “unë s’e kom problem atë punë hiç, paskem ardhë palidhje, paskem ardhë pa nevojë”, a din, fjaltë e mia. Megjithatë, ai tha, “Veç njo po të lutna”, tha, “tregojë të vërtetën” tha “kur të shkojsh”. “S’kom shka me tregu asni të vërtetë”.

³ Sekretarijat Unutrašnjih Poslova (SUP) - Sekretariati i Punëve të Brendshme që në kohën e RSFJ-së ka qenë emërtim për policinë.

Atëherë kemi pritë dikun edhe nja tri, katër orë, na ka ardhë vendimi, letra që keni me shku për Mitrovicë. Domethonë, momentin që ma kanë pru letrën, atëherë fati e deshti që me qenë edhe pak ma të forta. Qajo shoqja e Kamenicës qata e kishin marë në Kamenicë, na ishim shoqe, u njifshim shoqe, po me ata nuk kem pasë dishka që me thonë lidhje me këto raportet tona, fort nuk kem pasë, u njifshim, rrishim me to bashkë, po jo dishka lidhje. Edhe momentin, na qëllloi rasti me shku dyjat me ni kerr, ni kerr të policisë. Na futën njena knena, njenen knena, unë këtu. M'u njihtë u njifshin, ishim shoqe të fakultetit, ni grupi në letërsi. Ni femën në mesin tonë shqiptare, po më pytë mu tha, "Nga je ti?" I thashë, "Unë jom prej Deçanit, këtë shoqen" thashë "s'pe njoh". Domethonë, se po t'i thojsha e njoh këtë shoqen tani menxi s'pritshin me të gjetë.

Tjetra çka ka qenë interesant kur, para se me shku në Mitrovicë domethonë na shkojshin, na i mershin shenjat, fotografinë, shenjat e durëve, këto, këto, këto, të dhanat, numrin e syve e sikur... edhe kom shku edhe e kom pa emrin e shoqes teme, asej të Deçanit, në gozhdë, që e kish pasë emrin aty në atë listën, edhe p'e këqyri kush, kush ka qenë në fotografim ni ven i tmerrshëm, i msheltë, në terr. I lamë ato shejat, e pashë emrin e saj, thashë kjo veç paska hecë. Veç e gjetëm atje, ajo ni natë përpara neve, ata e kishin marë në konvikt. Edhe ndodhi, shkumë aty dej Mitrovicë, në Mitrovicë kur jemi shku, si zakonisht ato që jonë, ato procedurat me t'i hekë lidhësat e këpucave e këto e këto, e dokumenta e sene diçka.

U futëm, shkoj mrena, fati prapë aty e gjeta ni, ni shoqe që e kisha njoftë ma herët, e që ishte vajza e Kadri Osmanit, që e kishte edhe babën të burgosun. Pikërisht në qat' burg edhe ajo aty, edhe e kisha shumë ma lehtë tashti kur veç ajo e kishte bo ni përvojë aty mrena në burg, kish përvojën edhe të prindit që ishin. Po, pikërisht të njejtin burg e që baba i vetë i kish dikun nja dhjetë vjetë përpara en burg edhe i kish ra fati që edhe baba edhe vajza me qenë në të njejtin burg. Edhe unë e njifsha familjarisht domethonë se, u njifshim pak ma herët me, me këto, edhe ajo na, na udhëzojke tash pak, deri sa u adaptojshim me atë jetën e burgut me ato. Por e kishim fatin që ishim të rretheve të ndryshme, të Ferizajit kanë qenë dy mjeke atëherë studente të mjekësisë, unë e letërsisë, njo ka qenë e Rahovecit, juridik. Domethonë, krejt ato shoqet, tani domethonë e kemi kalu ni kohë edhe pse në burg domethonë u njifshim, e kishim atë idealin, mo përtej atyhit s'kishim ma keq, domethonë...

Anita Susuri: E juve kur ju kanë burgosë, ju a e keni ditë pse po ju marrin? Se ju faktikisht nuk ju kanë nxanë tu bo diçka keq.

Hatmone Haradinaj Demiri: Jo, ata jo, ata nuk na kanë nxonë. Por, ata veç na kanë përcjellë, domethonë të thashë edhe ma herët, domethonë ata veç fillojshin me përcjellë. Je konë në demonstratë, je konë këtu, je konë këtu, i kanë ditë kush tek shka, domethonë ata veç i kanë pasë të dhanat. Para se me shku domethonë kanë qenë disa inspektorë atëherë, shqiptarë po flas, gjithmonë shqiptarë, kanë ardhë në konvikt. Zakonisht domethonë në konvikt kanë ardhë, kanë hi kanë dalë, kanë këqyrë kush me kon po shoqërohet. Bile, ni vendasja e jemja ka qenë, sot osht' profesoreshë nuk

du me ja përmen emrin se më vjen keq, po më paralajmëroi dy-tri ditë kur kesh në konvikt. Tha, “Ti ke thonë” tha “për mu që jom shpiune”.

A faktikisht unë absolut nuk disha për atë punë që ajo ka dishka lidhje me atë, bile si personalitet e adhurojsha. Edhe kur më ka thonë qashtu thashë, “Ku kom thonë, ku kom thonë, kuj i kom thonë?” Se s’e kisha thonë atë fjalë. Tha, “Ke thonë”. Sa ish hapë konvikti numër V edhe patën bo kishe pak do kushte pak ma komode, na veç sa u vendosëm edhe i bojshim kishe nifarë kuzhine i kishim do resho [shporet i vogël elektrik] të vogla edhe aty përgatitshim, tha “Ke thonë qetu”, tha “në kuzhinë”. “Jo” thashë, “ti tregom ku, ku, cilit, kuj”, thashë “se në kuzhinë çka kemi folë na. Në kuzhinë s’kemi folë për kërkon kush osht’ shpiun, a kush ky, a kush osht’ ky”.

Edhe faktikisht aty e pashë, domethonë momentin, sepse tani ma vonë, e pashim që do vishin te ato rrishin, do inspektorë të Sigurimit, vishin u enshin me to. Edhe aty domethonë e vërejta që diçka, i kemi pasë mrena në konvikt t’u na përcjellë kush me kon po rrin, çka po bon. Pastaj osht’ majtë, kjo, loja me Slloveninë, kur kanë luftë vajzat në basketboll, në sallën “1 Tetori”, kemi shku edhe atëherë naj kanë mshelë derën mos me na lonë me dalë, unë kom dalë për dritare me pantufle, qysh, qysh i kom pasë edhe ato, më kishin përkshku shumë mirë. Kishin shkru, kishin tregu që, “Kjo ka dalë për dritare”. Edhe kanë shku drejtë në sallën “1 Tetori” me protestu, se atëherë protestat domethonë pas këtyne që pare [më herët], tash m’u kujtu.

Domethonë, pas vitit të parë ‘81-shin, atëherë ishin lojnat m’u organizu, në atë lojë kemi shku në sallë “1 Tetori”, dhe aty kemi fillu, kemi protestu, kinse po i mbrojmë lojtarët. Po edhe aty u bo ni, domethonë ni, ni, ni lloj proteste kishe në sport. Por tash me të thonë të drejtën “EHO” e përmenshim, qishtu disa fjalë e... tash besa me të thonë të drejtën nuk më kujtohen qaq cillat kanë qenë edhe ato parullat që i kemi përmend aty. Por, ni revoltë e madhe ka qenë, bile edhe naj kanë mbyllë toni dyrtë e jonë rrehë studentat, po fati që na kemi qëllu afër derës së hyrjes, se plot jonë rrehë deri sa jonë dalë, se aty u bo ni protestë domethonë, pas gjithë...

Anita Susuri: Kanë ndërhy edhe policia...

Hatmone Haradinaj Demiri: Kanë ndërhy policia, sigurisht. Edhe unë, ne, s’na kanë lonë me dalë për dere. Qysh kom qenë me pantufle, me pantufle jom dalë edhe... kur kom shku atje, në asi, tha, thashë, “S’kom qenë në atë lojë unë”, thashë “se unë, s’më ka pëlqy mu ajo lojë”. Tha, “Ke qenë”, tha “edhe ke qenë”, tha, “me pantufle pej konviktit”, tha, “ke dalë për dritare”. Edhe domethonë, po, u vendos ajo. Kushtet kanë qenë aty, ndoshta krejt e përmenin, po me të vërtetë osht’ ni burg, i tmerrshëm ka qenë. Domethonë, kushtet kanë qenë minimale, domethonë, asgja, s’ke pasë të drejtë me dalë për jashtë, edhe nevojat fiziologjike i kemi pasë me i bo mrena në dhomë, domethonë ajo ka qenë ma e tmerrshmja që munet me pasë dikush. Ka qenë e tmerrshme se s’ke mujtë, domethonë vetëm natën kur je ra edhe kur je çu në mengjes kur ka ra zilja. Je çu nga kreveti dhe u dashtë me nejtë në tokë ulun

domethonë ni shilte shumë e fortë as me u pështetë për, për shtrati. Ushqimi mo, dihet domethonë ka qenë jashtëzakonisht i dobtë. Atëherë kanë fillu, kanë fillu marrjet në pyetje.

[Këtu ndërprehet intervista]

Hatmone Haradinaj Demiri: Mu domethonë zakonisht në pyetje më kanë marrë jashtë burgut, ni ligj, atëherë kur kish qenë mrena burgut nuk i kanë torturu shumë nëse i kanë marrë në pyetje, po unë personalisht po thom edhe shumë tjera, po unë personalisht domethonë po thom, sa herë më kanë hekë prej burgut edhe më kanë çu në Sekretariat në Mitrovicë dhe atje domethonë i kem pasë torturat ma çnjerëzore, torturat ma çnjerëzore i kom pasë. Dhe pikërisht i kom pasë prej ni ish profesoreshe që ka qenë, ka punu në gjimnaz të Deçanit dhe ka kalu prej gjimnazit në Sekretariat të Punëve të Brendshme. Ka ardhë bashkë me ni, me ni inspektor të Drenicës, Lutfi Ajazi, që du me ja përmen emrin që ka qenë me të vërtetë kriminel edhe kjo bashkë me to. Kjo e ka nxitë me fjalë, ai ka përdorë dhunën.

Une nuk e di qysh jonë dhunu tjerat, po shoqet e dhomës më tregojnë. Thotë se nuk kena pa sa kemi nejtë në burg tortura ma të mëdhaja se te ti s'kem pasë kun, kom qenë, domethonë krejt trupi im ka qenë zi. Të nesërmen kanë shku shoqet e dhomave dhe kanë bo protestë, domethonë kanë protestu, kanë bo grevë urie, derisa osht' alarmu drejtoria e burgut. Drejtoria e burgut ka ardhë domethonë atë ditë, se unë as s'kom mujtë m'u ngritë në komë. Më kanë çu te mjektë e... absolut domethonë nuk kom pasë ndjenja domethonë, dikun nja dy, tri ditë hiç, hiç. Jom konë pa ndjenja. Por fati i asaj shoqes time që ajo më ka shpët, se gjithë natën u çu edhe më ka qitë peshkira të lagtë në trup. Edhe thotë, "Habitna qysh ke mujtë ti sot, qysh je në komë". Do kanë ndodhë, ma vonë domethonë.

Anita Susuri: E juve qajo gruja, qajo profesoresha ju ka keqtrajtu?

Hatmone Haradinaj Demiri: Ajo, ajo profesoresha, ajo hala ma keq. Domethonë, qysh i thojnë asaj fjalës të urtë: "Ma i zi shtisi, se dorasi". Ajo domethonë tha, "Kurrë ti s'ki me kry fakultet, na kena me të hekë prej kësajna. Ti shkollë s'ki me kry, ti don me prishë sistemin. Ti don me prishë Jugosllavinë. Kush je ti edhe trego kush të ka shti, kush të ka bo? Në atë onë, në këtë onë..." Kjo e nersojke [nxiste], ai sillke, domethonë më kanë çu nuk e di as vetë, momentin...

Anita Susuri: E pse juve qaq shumë domethonë, ju kanë keqtrajtu?

Hatmone Haradinaj Demiri: E tash ish problemi, që na ishim, të tregova, prej gjenezës së fshatit atje që ishim krejt, edhe e dishin ata që nëse veç e ki mbiemrin Haradinaj aty s'ish problem edhe hiç bash kurgjo mos me bo. Megjithatë, domethonë ato ishin ato, plus ish, e dike ajo shumë mirë vendase e jona, që e dike çka po ndodhë atje. Edhe tha, "A po më njeh? Edhe unë u tregova kokëfortë thashë, "Ty nuk të njoh absolut, s'e di kush je ti". "Unë jom profesoreshë". Thashë, "S'njoh profesoreshë që rrehë nxanësa, nuk njoh" thashë, "kurrë hiç në jetë". Edhe po ta thom të vërtetën se aty jom betu edhe ju kom thonë kështu, ju kom drejtu drejtë, thashë, "Unë nëse dal gjallë, përnime kom me u bo

profesoreshë”, thashë “nëse më mytë këtu”, thashë, “kom me mbetë”, thashë, “dikush ka me thonë që dikush e ka humbë jetën në burg për shkak të ni edukatori. Po”, thashë, “në momentin që kom me shku edhe kom me punu në arsim, e ti ma ke futë atë ndjenjën që tash unë kurrë s’kom me mendu dikun tjetër përveç në arsim. Po nëse vi në ditë të tua që ke ardhë ti, unë asni nxanës prej meje s’ka m’u torturu, as ditarin nuk kom me keqpërdorë qysh e ki keqpërdorë ti”. Edhe aty asajna i ka ardhë hala ma shumë, i ka ardhë inati.

Anita Susuri: E ajo qysh ka qenë profesoreshë edhe me qat’ qëllim ka punu që me...

Hatmone Haradinaj Demiri: Jo, ajo ka dalë toni mo, e ka lëshu, e ka lëshu gjimnazin edhe ka kalu ni post tjetër domethonë në Ministri të Punëve të Brendshme, si SUP-ovca⁴ atëherë qysh i kanë thonë. Domethonë në hetuesi ka kalu edhe e ka lonë atë profesion. Sot o gjallë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ishit tu na tregu për profesoreshën e juq që ju ka maltretu.

Hatmone Haradinaj Demiri: Pra, pikërisht ata që e tregova, ajo quhet Zyra Kastrati, osht’ vendase e jona atje e vendlindjes. Dhe po thom {psherëtinë}, u betova, u betova, pra në ni mënyrë u betova para sajna, e vazhdova rrugën time prapë. Në fakultet ish shumë vështirë pas daljes nga burgi, nuk ish e lehtë. Atëherë veç fillunë me na qitë në parapërdorim prej fakultetit, ishte ni komision diciplinor në fakultet që ishte formu. Edhe po, fati jonë thotë, profesori na thirri, domethonë na thirrën ni grup i profesorëve që e kishin bo ni komision edhe tha, “Ti ke qenë në burg”, tha, “ni diçka”, tha, “kemi bo për juve”, tha, “për ma të mirë jemi mundu, ju”, tha, “që jeni dalë prej burgut”, tha, “juve ju qesim në parapërdorim, ata që jonë në burg jonë dënu ni vjet, dy ata”, tha, “i përjashtojmë, se ashtu kështu”, tha, “jonë në burg”.

Në momentin që dalin, vetëm se e kanë marrë atë, atë numrin sa osht’ i dënum edhe për qat’ shkak domethonë nëse ka qenë dy vjet i dënum, dy vjet përjashtohet prej fakultetit. Kur ka dalë veç ai u kry dënimi i gjatë. Domethonë, e kanë mbulu profesorët e fakultetit, këta e kanë mbulu. Prandaj, pata fatin që na qitën në parapërdorim pra prej fakultetit. Ish ni vërejtje se na s’kemi nejtë rahat.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po du pak m’u kthy te burgu prapë. Na tregutë që ju kanë maltretu edhe që keni qenë tri ditë pa ndjenja. Po qysh ka vazhdu pastaj, a kanë vazhdu me dhunë fizike apo?

⁴ Njerëz që punonin në Sekretariatit e Punëve të Brendshme.

Hatmone Haradinaj Demiri: Atëherë po, atëherë drejtori i burgut ka ardhë edhe ka qenë domethonë baba i ni studentës, që kemi qenë na studente bashkë. S'po du me permend emër, ma vonë ju tregoj edhe domethonë ai u betu tha, "Mo", tha, "në pyetje kanë me të marrë, po jashta burgut jo, osht' ni ligj", tha "nëse mrena burgut je rrehë", tha, "na kemi të drejtë", tha, "me ndërpre ata, po nëse merresh në pyetje jashta burgut atëherë", tha, "s'kemi kurrfarë kompetence se osht' rregullorja e burgut që na nuk kemi të drejtë me ndërhy". Atëherë, domethonë kanë qenë maltretime pak ma shumë psiqike, por megjithatë ajo ishte, që ishte jashta burgut ai i burgosun që merrej në pyetje jashta burgut ato ishin tortura sepse ishin të pakontrollume.

Anita Susuri: A ju kanë marrë pastaj mo jashtë burgut?

Hatmone Haradinaj Demiri: Jo, mo toni nuk na kanë marrë, atëherë kom qenë në rehabilitim domethonë, deri sa jom shëru, qeshtu...

Anita Susuri: E ju na tregutë edhe ni, ma herët ni ngjarje me tasa, me emra qysh keni komunikë.

Hatmone Haradinaj Demiri: Eh ka qenë interesant edhe komunikimi. Pra edhe në rrethana ma të vështirat njerëzit gjejnë komunikim. Pra komunikimi jonë për më ditë se çka po ndodhë nëpër dhoma, cilat, kush po vjen, çka po ndodhë, kush, çka po ndodhë jashtë, komunikimi ka qenë me tasa të plastikës, të cilët i vnonim në vesh, e dëgjonim në muri edhe vinte ai zani si i telefonit. Pra krejt komunikim, mirëpo komunikimi ka qenë përmes pseudonimeve. Secila domethonë në momentin që, ato që ishin ma përpara në dhomë, e na që vishim domethonë që vishin të rejtat, atëherë në momentin që vishim secila e kishte ni pseudonim të vetin.

Dhe po flet me Norën, po flet me Shpatën, po flet me Iben, po flet... varet domethonë kon e kanë pasë idol secila. Secili i burgosun tash nuk po du me dallu gjini, pra secili i burgosun kon e ka pasë idol, diçka që ju ka dokë në jetë e ka pasë pseudonimin e vetë edhe përmes komunikimit të atyne tasave të plastikës kemi komunikë, "Kush, çka, çka po ndodhë, kush ka ardhë, kush është ajo vajzë?" Domethonë, ndoniherë bonim hajgare, ndoniherë domethonë varet prej, prej rrethanave, rrethanave kur ne e dinim se, nuk kish gardianë në qat' kohë se nuk mujshim gjithmonë me komunikë.

Mirëpo e patëm mësu atë lëvizjen e dyrve, domethonë lëvizja e dyrve sepse struktura e burgut të Mitrovicës ka qenë e rrumbullaktë edhe domethonë kur u çelë dera e parë, e dyta, e treta, e katërta e kemi ditë ren, çeli parë çelësa kanë hi në tjetrin, jonë çelë tjetra... domethonë ka pasë ndalesa me dyrë dhe e kemi ditë domethonë momentin, se muret kanë qenë shumë, shumë akustike, jonë ndëgjju. Prandaj domethonë e kemi vërejtë kur po vjen edhe faktikisht jemi ndalu. Domethonë e kemi pa, në bazë të çelësave e dishim kur po shkojmë se jonë afër edhe kur po vijnë që jonë afër edhe kemi komunikë në qat' kohë.

Natën jo, se ka qenë shumë qetësi. Domethonë, binim vonë u dashke mu çu në ora 5:00, kur i ka ra zilja domethonë ai alarmi edhe ti. Ka qenë si rregull ushtarak s'ke guxu mo me nejtë, ditën mo hiç se hiç, a ke smutë, ke, hiç absolut, s'bon. Pastrimi ka qenë i tmerrshëm, je pastru, noshta ta kanë lëshu ujin niherë në javtë ose në dy javtë ta kanë lëshu. Tamon ke fillu m'u bo me sapun e kanë nalë edhe je kthy pa pastru.

Anita Susuri: E dhomat, qelitë a kanë qenë të mëdhaja, a ka pasë shumë njerëz mrena?

Hatmone Haradinaj Demiri: Ka pasë, varet prej, prej situatës. Për shembull, nëse ishin rrethanat tash qysh ishin, për shembull datat e caktume 11 marsi, datat e përvjetorave e asishne, atëherë vinin edhe shumë ma shumë. Pra ndodhke me konë deri në dymbëdhjetë vetë, pra deri në dymbëdhjetë vetë kanë mujtë me qenë me ni dhomë, në qoftë se s'ka pasë krevet ke flejtë në tokë. Edhe kur ke flejtë domethonë, ai dysheku, e ke pasë gati domethonë ku me nu [vendosë] dorën, ku me nu këta. Krejt ka qenë njeri i vizatumë, se pa u ndërru kurrë ai [dysheku], i njeiti nuk e ke pasë dyshekun domethonë me mujtë, po u dashtë me lëshu dorën krejt, vija ka qenë e dorës, kjo e dorës e shpinës, krejt njejtë, s'ke mujtë, rrotullou qysh të dush, ke ra sikur me ra në ni kallëp {e përshkruan pozitën me duar}.

Anita Susuri: E a kanë qenë të mëdhaja ato dhoma?

Hatmone Haradinaj Demiri: Kanë qenë, po qeshtu... me thonë të drejtën, jo shumë të mëdhaja, të vogla kanë qenë dhomat. Krevetat knej, knej, krejt domethonë krejt ato krevetat dyshe edhe ni pjesë sa ke mujtë, sa ke mujtë me pasë pak shilte edhe s'ka pasë... aty tualeti i improvizumë.

Anita Susuri: A keni dalë në gjyq, a qysh ju kanë caktu për shembull burgimin?

Hatmone Haradinaj Demiri: Ata, po kush jonë dënu me, domethonë pas ni vjete kush ka nejtë ni vjet e ma tepër, domethonë ata ose dy vjet, varet sa e kanë pasë ata, ata të caktume, ato hetuesinë. Unë nuk kom dalë në gjyq, unë kom qenë vetëm e izolume, domethonë as nuk kom pasë gjyq, as s'kom pasë të drejtë me, as s'kom pasë të drejtë me pasë vizitë, as me kërkua diçka, as me ardhë, domethonë krejt gjithmonë je konë, ni lloj izolimi, hetuesie. Derisa sa jonë, ashtu kur ma kanë kthy vendimin thotë jonë kriju rrethanat që munden këta me dalë, domethonë vendimi ka qenë izolim edhe në momentin kur jemi dalë [vendimi] thotë: "Tash jonë kriju rrethanat që këta munden me dalë". T'u mendu që prapë, domethonë ata gjithmonë, na kemi qenë tash në atë situatën të vëzhgumë që p'e lomë edhe pak me bo edhe me ardhë herën tjetër, domethonë kjo ka qenë ajo strategjia e tyne.

Anita Susuri: Ju keni qëndru dy mujë apo?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, ma shumë besa, ma shumë se dy mujë. Po, megjithatë qato kanë qenë ato rrethanat...

Anita Susuri: E kur jeni dalë prej burgut, a ka ardhë dikush me ju marrë a qysh ka qenë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Jo, jo, kur jemi dalë prej burgut ajo ka qenë hala ma e vështirë, domethonë kurkush s'ka ardhë me na marrë, kurkush s'e ka ditë se na s'kem pasë vizitë hiç domethonë krejt ajo, as s'kem pasë vizitë. Faktikisht mezi i kanë tregu prindit tim se ku jom, nuk e ka ditë hiç domethonë ka ardhë në Prishtinë te burgu, s'osht'. Ka shku te Lipjani, s'osht'. Kah? I ka thonë dikush, "Shko te Mitrovica, ndoshta osht'". Fati ka shku te Mitrovica, ka qëllu në profesorin tim të ndjerë që e vranë gjatë luftës, Latif Berishën edhe ka qëllu rasisht në autobus me to, edhe ai e ka dërgu te burgu, s'e ka ditë ku osht' burgu i Mitrovicës. Edhe s'e kanë leju domethonë kurgjo hiç, vetëm se ai ka dashtë me ditë ku jom. Atëherë, u dalë më ka ble diçka ni kollodont aty çka ka mujtë për momentin me ble edhe me i lonë dej aty, me u pa absolut hiç. Qajo ka qenë.

Edhe kur jemi dalë, domethonë jemi dalë fatbardhësisht, jo që, me atë shoqen time prapë domethonë gjithmonë më ka lidhë diçka, me atë shoqen e shkollës së mesme që kemi qenë. Jemi taku në stacion të autobusave, menxi edhe ata e kemi gjetë, stacionin, se ish hera e parë që shkonim në Mitrovicë. Edhe në stacion të autobusave, pare s'kishim, kurgjo hiç as ajo as unë. Metëm kuj me ju drejtu, rrethanat jo të lehta, ish koha masdite edhe shka me qëllu motra e ni shoqes janë kanë ato dyjat të Mitrovicës, atëherë i kem pasë, bile i kom në fotografi e m'u ka kujtu.

Kur jom taku me to tha, "Ç'a u bo?" Thamë, "Më lëshunë mu, të lëshunë ty", u takumë në stacion të autobusave. "Tash shka me bo për pare?" "Hajde", thashë, "se më duket motra e Leonorës osht', punon në stacion aty", ni Laura ka qenë, Laura Aliu s'ia harroj emrin. Ju kom ofru i thashë, "Laurë", thashë, "kështu, kështu, kështu... na kanë lëshu prej Mitrovice çka me bo?" Tha, "Biletat i keni prej meje". Na i ka pagu biletat edhe na i ka dhonë paret me u kthy prej Pejë në Deçan. S'kishim pare. Na i ka pagu biletat, jemi hypë në autobus.

Jemi kthy në Deçan prapë në Isniq, kemi shku te ajo se në fshatin tem ish edhe shumë ma larg, autobus s'kishte vonë edhe u dashtë me shku te ajo. Kurkush s'e dike që po shkojmë as familja e asaj shoqes, as unë. Kur kemi hy në Isniq, kemi shku në komë, nata, terr, qentë ishin lëshu, veç na dyjat, kemi shku te dera. Ajo e ka pasë nonën edhe babën pleq, shumë të vjetër ishin konë, vllaznit jo aty, jashtë. Ata dy pleqtë tu hongër bukë a shka jonë konë, dikun mas darke.

Edhe tash qysh me ju ra në befasi thashë, "A din çka unë..." se ajo emrin e ka pasë Time po në shpi e kanë thirrë Sanije edhe unë e kom thirrë, "Oj Sanije, oj Sanije" edhe u dalë nona e vetë, "Kush osht' ai zo, a osht' i çmendun", thotë, "që del dikush edhe ma thirrë çikën në këtë, në këtë moment". Kur u dalë jashtë unë i kom dalë përpara që mos me i ra në befasi thashë, "A po na len mrena se jemi kthye". Atëherë na kanë kapë për qafe, kemi bujtë atë natë, kemi nejtë, të nestrit jom shku. Prapë e kom marrë unë ata, toni e kom shku te shpija. Këto kanë qenë ato rrethanat.

Anita Susuri: Në shpi te ju, si ju pritën juve?

Hatmone Haradinaj Demiri: Mirë, tani kur u, shkum na ata u gzunë e san. Por, ju ra befasi, se ata as që e kishin mendu mo ishin metë, tash as, as kurgjo. Atëherë s'ke mujtë kurrqysh qysh me shku me thonë, "Po shkoj me pa e s'po shkoj me pa. Hiç!" Domethonë, për shkak se ju kanë thonë, "Ju s'keni të drejtë hiç, ju tregojmë na kur". Ata s'dishin kurgjo, megjithatë kaloi edhe ajo situatë. Sa ma shumë domethonë hala ma zi toni na bonë nacionalistat edhe ma zi se toni ish ai inati, inati i asajnan që... U ktheva në konvikt t'u mendu që tashti më lonë në konvikt, prapë vi në konvikt, vij në konvikt, më thotë, "Hec dil jashtë, ti s'ki të drejtë me..." thashë, "E kom kry unë burgun", thashë, "jom dalë pa faj". A di, si, si zakonisht tha, "Jo", tha, "ti", tha, "kurrë hiç në konvikt", tha "mo këtu". Jom dalë.

Ka ardhë qajo shoqja jem e Drenicës që tregova, që kem fillu demonstratat, ka ardhë baba i vetë edhe e ka hekë ata prej konviktit. Ka thonë, "Ti s'ke me lonë vetëm, ti del prej konviktit e shko vendos me këta". Prapë jemi shku qai grupi i '81-shit jemi bo bashkë, gruja e Ali Lajqit, gruja tash e Ukshin Hotit, unë, ato. Prapë jemi bo ni celulë në ni banesë, kemi banu bashkë, prapë kemi vendosë... Por fatbardhësisht, domethonë edhe ai pronari i banesës që ishte e dike cilët jemi na edhe na ka lonë edhe kurrë s'na ka nalë çfarëdo demonstrate, çka ka ndodhë toni, çka ka ndodhë trazira. Ai gjithmonë thojke, "Veç mos të ju sheh kush, mos te ju nxen kush. Hini në shpi."

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani aktiviteti ju. Deri kur keni qenë në këto aktivitete?

Hatmone Haradinaj Demiri: Eh, në këto aktivitete kemi qenë dekteri në vitet e '90-a, në vitet e '90-a atëherë kom fillue, kemi hi atëherë me thonë pak në Lidhjen Demokratike, kur u fillu ajo me Rugovën. Fillova pak me aktivitet si në Forum të Gruas, vazhdova dikun deri në vitin '92, '93 atëherë fillunë, fillunë këto partitë politike, fillunë ndarjet, ky me këta, ai me këta, ky kështu, atëherë mo... Prej '93, '94, '95, mo nuk... domethonë kom nejtë, punë s'kom pasë të drejtë me hi. Domethonë, unë diplomova me kohë, punë... u bonë 13 vjet punë hiç, diplomova...

Anita Susuri: E qysh e vazhdu të fakultetin që thatë më kanë përjashtu?

Hatmone Haradinaj Demiri: E vazhdumë në parapërjashtim, jo në përjashtim, në parapërjashtim domethonë, vërejtja e fundit. Në qoftëse ke dalë je konë në parapërjashtim, po kishe të drejtë me shku. Ata që u përjashtojshin ishin të dënumë, domethonë ishin mrena në burg. S'e di a e kuptove. Domethonë ishte ajo, parapërjashtim, kështu që e vazhdumë shpejtë e shpejtë. Profesortë, thotë, "Shikoni, runu se..." Por, fatbardhësisht ishte Hasan Mekuli, ni profesor, kanë qenë do profesorë shumë te mirë, që ata domethonë e bonin edhe atë punën që sistemi, që ja u imponojke diçka me bo. Por, megjithatë ata na kanë mbrojtë me atë mënyrën që me të lonë në parapërjashtim, "Po ti shko në shkollë hec, vazhdo ti kryje". Veç në momentin që bishe u dënojshe prapë, të përjashtojke, ish qajo periudha.

Anita Susuri: Po a ka pasë naj aktivitet që, të njëjtë që e keni zhvillu mas burgut, apo qysh për shembull çka keni bo?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, prapë kemi vazhdu na në qoftëse, kur jonë majtë protesta, e domonstrata, e tani mo aktivitetet i kemi bo. Toni këto për Drenicën e për... vitet e '90-a, mo asniherë s'jemi nalë. Edhe pse domethonë jom martu e kom qenë nanë, e kom marrë edhe burrin, se me burrin kemi qenë shokë fakulteti. Bile u konë interesant se burri po më thotë tha, "Unë" tha "nëse na martohem bashkë, a je në gjendje me më pritë, nëse bi në burg", tha "a më pret?" "Paj, e kqyrim" thashë, "ja ti, ja unë", thashë "njonin". E unë rava para tij, thashë, "Pritëm tash" (qesh).

Domethonë se edhe ai ka qenë në aktivitet, ka qenë me Nuhi Berishën tash që osht' vrarë në celulat e para Ahmet Isufi, ka qenë ky në Gilan në atë, në atë pjesën tjetër, me aktivitete, me të gjithë ata. Kështu që, prapë edhe me atë na ka lidhë edhe fakulteti. Domethonë kemi qenë katër vjet shokë fakulteti, po kem qenë edhe shokë të idealeve. Ndoshta ka qenë edhe ajo ura lidhëse që jemi njoftë me, me rrethe të tjera... kjo ka qenë.

Anita Susuri: E kisha dashtë veç me ju pytë për vitet e '90-a këto që i përmendet, për shembull marshi me bukë ka qenë, liri për Drenicën, ka qenë me letër të bardhë, me çelësa...

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, krejt, me letër, me çelësa, me këto protesat që jonë majtë në Dragodan, "Drenicë jemi me ju", të gjitha protesat. Ndoshta jo krejt, se unë atëherë kom qenë, në vitin '93 veç më ka lindë djali e kur kom qenë unë, po edhe atëherë e kom gjetë momentin kur e kom pa dikun që kom me lonë fëminë, jom dalë domethonë s'jom nalë. Se edhe burri, po edhe ai ka qenë gazetar edhe ai domethonë shumë herë ka qenë protestues vetë edhe u rrehë nëpër ato protesta. Pikërisht domethonë jonë torturu me Ali Zatriqin në protesta edhe i ka tejkalu ato rrethanat edhe pse ka qenë gazetar, se na kemi qenë krejt me ni ideal tjetër edhe kaniherë ka ikë prej rreshtit të gazetarëve, ka dalë ka protestu... Domethonë asniherë s'jom nalë deri sa jemi sot ku jemi. Jom mundu me dhonë atë kontributin tem sa më ka taku edhe si femën edhe si atdhetare edhe si, m'i ndihmu çështjes. S'e di sa ia kemi arritë qëllimit, kurrë s'osht' boll, kurrë s'o boll, po...

Anita Susuri: Kisha pasë dëshirë me diskutu edhe për luftën e fundit domethanë në Kosovë. Ka fillu dikun herët në vitet e '90-a, po ma shumë është shfaqë në '98-ën edhe si përfundim '99-a...

Hatmone Haradinaj Demiri: '98-ën po, '98-ën po, '98-ën domethonë veç atje në Dukagjin ka fillu pak ma herët. Pesë javë mas familjes Jashari u djegë shpija jem e parë në Dukagjin, domethonë shpija e parë në Rrafsh të Dukagjinit pas Jasharajve osht' djegë, shpija e familjes teme. Atëherë domethonë ka qenë ni sulm, me 24 mars, '98-ën kur ka ndodhë, domethonë Ramushi [Haradinaj] kur i kanë bo rezistencë edhe domethonë gjatë asaj rezistence tenkat kanë ardhë edhe jonë, jonë pozicionu para shpisë. Aty domethonë osht' shpija osht' djegë, po fatbardhësisht domethonë nona ka mbetë veç vetë

aty në shpi, atë natë domethonë ka mbetë i vetmi njeri në fshat, ka mbetë domethonë, kur e kanë gjujtë ajo ka qenë veç mrena në shpi.

Tjertë, dikush ka, ka shku, kanë ikë domethonë vëllau me fëmi, e me kunatë e me motra, kanë shku, dikush o metë në shkollë, dikush o metë në fakultet, domethonë kurkush s'ka qenë bashkë. Po vetëm nana ime ka metë mrena në shpi edhe thotë, "Nuk e di as vetë qysh jom dalë", thotë "prej flake, qysh e kom gjetë rrugën". Ka dalë, kur ka dalë "I kom lëshu", tha, "loptë, edhe jom mundu me shku te kojshitë me këqyrë a ka metë dikush me ju qitë lopëve ujë". Edhe në moment të caktume tha, "S'ka asni njeri në fshat hiç absolut", domethonë e vetmja ajo, qato kanë qenë ato rrethanat, jo shumë të lehta.

Domethonë, unë, prapë m'u ka dashtë me shku, kom ngajtë vrap me shku, qysh me shku prej kahit, e me lonë djalin e me shku nëpër postbllloqe se... kur në mëngjes e kom pa prej televizionit të Zagrebit, kush i jepke... i jepke lajmet edhe kom thonë në mëngjes, m'u boftë shpija rrafsh me tokë. Mo s'kom pritë hiç, e kom lonë djalin thashë, "Kushdo le tëm zan, unë kom me shku", edhe kom shku {psherëtinë}.

Anita Susuri: E qysh u konë me kalu në qato postbllloqe?

Hatmone Haradinaj Demiri: Ka qenë, jemi shku për Prizren, jemi shku për Prizren, jemi shku rrugëve të ndryshme me burrin, se ai ka qenë gazetar edhe rrugëve të ndryshme. Përmes shoqnisë së atijna, domethonë jo drejtë postbllloqeve me shku drejtëpërdrejtë, se me shku knej ka Komorani mo s'ka pasë shansë. Jemi shku në Prizren, kemi bujtë në Prizren, ka Prizreni nuk e di as vetë ka na kanë qitë nëpër fshatra, ku kemi mujtë, del, del anej, del knej, ma në fund kemi mrri në Gjakovë.

Anita Susuri: E pastaj...

Hatmone Haradinaj Demiri: Vllaznitë e mi kanë qenë, dy vllazën, edhe ata të inkuadrumë në luftë domethonë, mirëpo kanë shpëtu. Jonë vra shumë në fshat, prapë domethonë ai fshati jonë që filloi kur e nisëm '81-shën... në vitin '99-ën, 17 djem për ni ditë jonë vra, të ri. Domethonë të gjithë ata djem të ri jonë vra për ni ditë edhe tjerë, po ata domethonë jonë hi në ofensivë jonë vra 17 djem. Prej atyne, fati, ka shpëtu veç vllavi jam, i ka ra se ky ma i vjetri ka qenë prej atyne dhe këtij i kanë dhonë detyrë. Thotë, "Ti ki me shku me marrë ujë, se na jemi tonë ma të ri, ty po të bjen se je ma i vjetri me shku me na pru ujë' edhe kom shku, kur jom kthy..." ka ra pre dhe krejt njeni ka shpëtu prej atyne, prej gjithë qatyne, pak ma gjallë. Edhe i ka thonë vëllaut, "Mos më le në dorë të shkijeve" ky e ka marë në krahë domethonë, me kilometra e ka pru deri në fshat. "Më diq" tha, "në krahë", tha, "po, amanetin" tha, "s'mujsha" tha, "aty me lonë... tjertë metën". Kthehet...

Anita Susuri: E këtu në Prishtinë, qysh ka qenë dita kur fillunë bombardimet a të kujtohet?

Hatmone Haradinaj Demiri: Po, po, kemi qenë këtu, kemi qenë në Breg të Dillit si zakonisht te shpija, bombardimet fillunë... Atëherë ish, besa me thonë të drejtën ni ankth edhe ma shumë, i kisha dikun 26 anëtarë në shpi, familjen teme, nonën, babën, motrën, kunatën me fëmi, studenta, dy, tre studenta i kisha aty, profesori ka qenë, Sali Bashota bashkë me pesë vajzat e veta aty, domethonë të gjithë, ni... Nuk ish tmerri i, i im, sa ish i tjerëve tash se kishim plot aty domethonë, fëmi, e të ardhun e, tash secili, ishim besa edhe me ni ven jo fort të përshatshëm aty në Breg të Dillit. Tmerr! I qëndrumë atynëve ditëve, do ditë qëndrumë, dikun ka 1, 2 prilli [1999]... kemi shku në lagjen të Muhaxherëve jemi transferu. Unë kom qenë kembengulëse m'u hekë prej atyne, se e pashë që na s'kishim kurrfarë mundësie edhe i kom marë jemi shku në lagjen e Muhaxherëve. Pastaj, domethonë prej aty kemi qëndru nja dy, tri ditë edhe jemi dalë si të gjithë tjetër... në stacionin e trenit edhe jemi shku...në Bllacë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë aty te stacioni?

Hatmone Haradinaj Demiri: Aty te stacioni i trenit ka qenë ai tmerri ma i madh. Tmerri ka qenë qysh kemi dalë deri aty, se kemi shku rrugës ka biblioteka, kur jemi shku te biblioteka universitare aty jonë kanë paramilitartë krejt me... të armatosun me kallashnikova, me sene, me asishne. Menxi jemi dalë domethonë, jemi kanë ni grup jo shumë i madh, po as shumë i vogël jo. 50 anëtarë në atë shpi që na kanë majtë në lagje të Muhaxherëve, na kanë majtë atë natë aty, tri, katër netë kemi nejtë. Po ai zoti i shpisë u ardhë edhe tha, "Unë" tha, "dekteri të ju qesë në stacion të trenit vi edhe kthena prapë se" tha, "keni dalë prej konakit tam".

Në mëngjes u çu ajo gruaja e shpisë, pronarja me gjithë vajzën e vetë, ajo osht' profesoreshë në shkollën e mesme ekonomike, Hajria, që u çu bashkë me nonën e vetë edhe kanë bo krejt bukë. A faktikisht pronarja e shpisë, ju kish vra vëllau në Fushë Kosovë, i kish metë në rrugë. E kish kunatën aty me dy fëmi, tanë kohën t'u qajtë. Ajo u çu me qat' kijamet, u çu edhe e ka bo, krejtve na ka përcjellë tonë ata vetë. Jonë çu natën kanë bo bukë edhe asnjë pa bukë, "Ku me ditë çka ndodhë me juve", krejt bukën na ka dhonë me veti.

Plus domethonë në shpinë e tyne kanë nejtë dikun nja katër-pesë studentë gjatë gjithë kohës, sepse ka qenë edhe fakultet shpia e tyne aty. Shpinë e madhe, ata kanë qëndru edhe i kanë majtë qashtu, ata dy pleqtë, djemtë kanë shku toni, vajzat, ata dy pleqtë kanë nejtë në shpi edhe qata studenta. Mo ma vonë që s'kanë pasë rrugëdalje ka me dalë, në tavan i kanë majtë dekteri sa jonë kthy, ju kanë çu bukë tinza ata dy pleqë. Ai plaki ka dekë, plaka o gjallë, po domethonë atëherë une e kom marrë qat' kunatën e asaj plakës me dy fëmi, fëminë tam edhe tjetër. Jemi mundu mos me shku truq, dikush anej, dikush knej edhe jemi dalë.

Anita Susuri: Ku, pastaj, qysh...

Hatmone Haradinaj Demiri: Pastaj domethonë jemi shku në Bllacë, në momentin që jemi shku në Bllacë, jemi metë pesë netë aty, domethonë e improvizumë nifarë, nifarë, qysh me thonë, kasolle, s'po thomë kasollë veç e improvizume diçka, si shatorr me thonë, shatorr i improvizumë me, me qese të najllonit. Burri dul, tu mendu që... ishte baba im shumë i smutë edhe motra edhe e kanë marrë e kanë qite ata, ata kanë dalë. Na kemi metë me djalin, me motrën, me tjetër ran, kush kemi shku mo atëherë s'e kemi ditë kush, çka po ndodhë, me ni, gati ni milionë vetë.

Kemi qëndru shumë, pesë netë aty, jo shumë lehtë. Unë e kisha ni, se s'e disha serbishtën, se kush e dike serbishtën ju jepke pare pak maqedonëve, i lejoshin me dalë. Deri sa u lëshu [hap kufini], domethonë pas atyhit jemi dalë në Stankovec... në Stankovec edhe aty kemi nejtë nja katër-pesë ditë, jemi shku në Tetovë tani. Nuk jemi shku jashtë, s'ka dashtë shoku me shku jashtë edhe jemi shku në Tetovë kemi qëndru edhe aty tre mujë.

Anita Susuri: E kur u kthytë në Kosovë?

Hatmone Haradinaj Demiri: Kur u kthymë në Kosovë, shkrum...

Anita Susuri: A jeni kthy menihërë a qysh?

Hatmone Haradinaj Demiri: Menihërë jemi kthy, domethonë në Kosovë jemi kthy mas ni javë dite, menihërë, menihërë jemi kthy. Edhe pse s'kem pasë shpi tonën hiç, jemi konë me qira, na prapë jemi kthy të partë. Bile ai pronari tha, "Krejt kom mendu që, që kthehen por ju s'kom besu kurrë". Ai e kish shpinë katër katëshe, e krejt kushtet, djemtë i kishin shku në Amerikë, na jemi kthy (qesh)...kështu ishte jeta...

Anita Susuri: Edhe mas luftës, qysh jeni rimëkëmbë, qysh ka vazhdu jeta ju?

Hatmone Haradinaj Demiri: E tash, mas lufte jeta s'ka qenë shumë e lehtë, deri në vitin 2004, në 2004 domethonë, e kom pasë fatin bashkëshorti më ka vdekë. Edhe jom përballë domethonë pak me jetën si kryefamiljare, me djalin, me shkollimin, po punën s'e kom nalë. Domethonë, prapë ju kom jepë arsimit, jom mundu me punu prapë, me bo punën teme se kurrë s'mu ka dukë boll. Kom punu nja nantë vjet si trajnere në dy-tri projekte me kanadezë, mësimdhanja me nxanësin në qendër edhe ndoshta për m'i kalu të gjitha ato sfida, puna më ka lonë për mos me u... mos me u demoralizu, mos me u mërzitë edhe s'kom pasë kohë. Domethonë nuk i kom lonë vetit kohë me u mërzitë, po i kom lonë vetit kohë veç me punu edhe për djalin edhe për nxanësat. Asniherë aktiviteteve s'ju kom largu.

Pa marrë parasysh që i kom edhe tri vjet me dalë në pension, unë kurrëniherë aktivitetin nuk e nali, thashë betimi jem per arsim osht'... sa kom mujtë me dhanë nuk e di, por që gjithmonë e kom pasë synim që ata çka duhet me dhanë, hiç mos mujsha, dashurinë kom me jau dhonë, edukatën kom me dhonë, kulturën kom me u mundu me ja dhonë, ata çka e kom për veti, s'e di sa e kom. Megjithatë

domethonë, gjithmonë jom konë në shërbim të nxanësit, në shërbim të atyne që kanë pasë nevojë për mu, sidomos...

Jo vetëm në mësim, po ndoshta kanë pasë nevojë edhe për, për mbështetje materiale, për mbështetje morale, për me i përkrahë sepse na fillumë domethonë... në vitin 2000 fillova me punu mas 13 vjet diplomimi. Fillova në vitin 2000 edhe asniherë nuk jom nalë. Kom udhëheqë edhe dy herë kom qenë drejtoreshë kom udhëheqë edhe shkollën, kom punu edhe në arsim, po kënaqësia ma e madhe u konë me ditar, asniherë s'mu ka dukë që... po çka më ka shty m'u bo drejtoreshë, më ka shty duke i pa do padrejtësi që jonë bo drejtorëve nëpër shkolla, atëherë kom mendu, kom thonë, "Kom me u bo udhëheqëse po... me qenë e drejtë", domethonë mos me pasë kurgjo në xhepin tim.

Anita Susuri: Faleminderit shumë për intervistën edhe kohën.

Hatmone Haradinaj Demiri: S'e di sa, ndoshta pak...

Anita Susuri: A doni edhe diçka me shtu për fund?

Hatmone Haradinaj Demiri: Jo, s'po di. Tash me shku te shpija të thomë gjysën i kisha... po jonë kaniherë a din këto, unë po thom këto jonë spontante, nashta ka edhe shumë gjana ma të mira me tregu... Kështu që, unë nuk e di sa ju, sa ju ka pëlqy juve, qysh ju del.

Anita Susuri: Shumë mirë. Faleminderit shumë!